



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

[www.legjislacioni.gov.al](http://www.legjislacioni.gov.al)

**Nr. 62**

**Datë 5 maj 2014**

## P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr. 236, datë 23.4.2014	Për miratimin e planit të veprimit për zbatimin e vendimit pilot të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut “Manushaqe Puto dhe të tjerë kundër Shqipërisë”.....	2369
Vendim i KM nr. 237, datë 23.4.2014	Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit.....	2377
Vendim i KM nr. 238, datë 23.4.2014	Për shpalljen e lagunës së Karavastasë si zonë bashkëmenaxhuese e peshkimit.....	2384
Vendim i KM nr. 245, datë 30.4.2014	Për përcaktimin e kushteve dhe të procedurave për përmirësimin e përditësimin e të dhënave të regjistrit të pasurive të paluajtshme.....	2384
Udhëzim i MPB dhe KMDHP nr. 95, datë 7.4.2014	Për përcaktimin e institucioneve dhe organeve që marrin të dhëna personale nga shërbimi i gjendjes civile, si dhe mënyrën, llojin dhe sasinë e informacionit që duhet të marrin.....	2386
Vendim i ERE nr. 15, datë 13.3.2014	Për miratimin e raportit vjetor të ERE-s “Gjendja e sektorit të energjisë dhe veprimtaria e ERE-s gjatë vitit 2013” .....	2395
Vendim i ERE nr. 16, datë 13.3.2014	Mbi miratimin e udhëzuesit për menaxhimin dhe alokimin e kapaciteteve në projektin Trans Adriatic Pipeline (TAP) për fazën e parë të rezervimit ( <i>First Booking Phase</i> ) sipas “Opinionit të Përbashkët Përfundimtar/ <i>Final Joint Opinion</i> ” në kuadër të procedurës së përjashtimit për gazsjellësin TAP .....	2395
Vendim i ERE nr. 17, datë 13.3.2014	Mbi shqyrtimin dhe miratimin e “Njoftimit të fazës së rezervimit/ <i>Booking Phase Notice</i> ” paraqitur nga TAP AG për procedurën e alokimit të kapaciteteve të gazsjellësit TAP në përputhje me udhëzuesin e aprovuar me vendimin nr. 16, datë 13.3.2014.....	2397

Vendim i ERE nr. 18, datë 21.3.2014	Për fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “EnRel Hydro” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Zerec 1” dhe “Zerec 2”.....	2399
Vendim i ERE nr. 19, datë 21.3.2014	Për fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “EnRel Hydro” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.....	2399
Vendim i ERE nr. 20, datë 21.3.2014	Për licencimin e shoqërisë “MTC Energy” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Radovë”.....	2400
Vendim i ERE nr. 21, datë 21.3.2014	Për licencimin e shoqërisë “MTC Energy” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.....	2400
Vendim i ERE nr. 22, datë 21.3.2014	Për kualifikimin e impiantit prodhues të shoqërisë “MTC Energy” sh.p.k. nga HEC “Radovë”.....	2401
Vendim i ERE nr. 23, datë 21.3.2014	Për fillimin e procedurave të licencimit të shoqërisë “Danske Commodities Albania” sh.p.k. në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike.....	2401
Vendim i ERE nr. 24, datë 21.3.2014	Mbi kërkesën e shoqërisë “CEZ Trade Albania” sh.p.k. për fillimin e procedurave për heqjen e licencave: nr. 91, seria TE10P dhe nr. 92 seria FP10K dhënë me vendimet nr. 1 dhe nr. 2, datë 20.1.2010 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike dhe të furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike.....	2402
Vendim i ERE nr. 25, datë 21.3.2014	Mbi kërkesën për fillimin e një procedure hetimore administrative për shpalljen absolutisht të pavlefshme të vendimeve nr. 69 dhe 70, datë 12.12.2007, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s që kanë transferuar licencat nga shoqëritë koncesionare “Essegei Shqipëri Smokthina” sh.p.k. dhe “Hydroelectric Company of Albania” sh.p.k. te shoqëritë “Albanian Green Energy” dhe “Balkan Green Energy”.....	2403
Vendim i ERE nr. 26, datë 21.3.2014	Mbi kërkesën e një prej aksionarëve të shoqërisë “Projeksion Energji” sh.a. për heqjen e licencës dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis palëve.....	2403
Vendim i ERE nr. 27, datë 31.3.2014	Për miratimin e kontratës tip mbi verifikimin e matësve kur futen për herë të parë në treg dhe/ose kur vendosen për herë të parë në përdorim; inspektimin periodik për verifikimin e saktësisë së matësve dhe të sistemit të matjes së energjisë elektrike, kolaudimin dhe vulosjen, si dhe të mirëmbajtjes së tyre.....	2404
Vendim i ERE nr. 28, datë 31.3.2014	Për fillimin e procedurave të licencimit të shoqërisë “Power Wind Energy” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike....	2405
Vendim i ERE nr. 29, datë 31.3.2014	Për licencimin e shoqërisë “Ayen Energy Trading” sh.a. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.....	2405
Vendim i ERE nr. 30, datë 31.3.2014	Për licencimin e shoqërisë “Ayen Elektrik Trading” sh.a. në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike.....	2406
Vendim i ERE nr. 31, datë 31.3.2014	Për fillimin e procedurave të licencimit të shoqërisë “Gurshpate Energy” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Gurshpate 1” dhe HEC “Gurshpate 2”.....	2406
	Vendim për shpalljen të zhdukur të shtetasit Muhamed Demaj.....	2407

**VENDIM**  
**Nr. 236, datë 23.4.2014**

**PËR MIRATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT PËR  
ZBATIMIN E VENDIMIT PILOT TË GJYKATËS  
EUROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT  
“MANUSHAQE PUTO DHE TË TJERË KUNDËR  
SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e planit të veprimit për zbatimin e vendimit pilot të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut “Manushaqe Puto dhe të tjerë kundër Shqipërisë”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen të gjitha ministritë dhe institucionet qendrore për të cilat në planin e veprimit janë përcaktuar detyra të veçanta për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**

**RAPORT VEPRIMI**

“MANUSHAQE PUTO”, ANKIMET NR. 604/07,  
43628/07, 46684/07 DHE 34770/09, VENDIMI  
31.7.2012, FINAL ME 17.12.2012

**1. Hyrje**

Moszbatimi i vendimeve të formës së prerë që njohin të drejtën e kthimit/kompensimit për pronat e konfiskuara gjatë regjimit komunist, është pa dyshim një problem i hershëm strukturor i sistemit ligjor shqiptar. Në takimin e tij të 1186-të CM-DH (dhjetor 2013), qeveria e Shqipërisë shprehu angazhimin e saj për të vënë në funksionim, brenda afatit kohor të caktuar nga Gjykata (17 qershor 2014), një mekanizëm efektiv të kthimit/kompensimit dhe të paraqesë pranë Komitetit, pa vonesë të mëtejshme, një plan veprimi të hollësishëm dhe gjithëpërfshirës për zbatimin e vendimit pilot të Gjykatës Europiane Manushaqe Puto dhe të vendimeve të tjera në grupin e çështjeve Driza.

**2. Parashtrimi i problematikës**

Gjykata e Strasburgut në vendimin e saj pilot “Manushaqe Puto kundër Shqipërisë”<sup>1</sup> ka konstatuar se ka pasur shkelje Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) për shkak të mosfunksionimit të mekanizmit ekzistues të kthimit dhe kompensimit të pronave të konfiskuara gjatë regjimit komunist. Ky mekanizëm ka

rezultuar joefikas, sa kohë që ka zgjatur rreth 20 vjet pa ofruar zgjidhje të drejtë dhe përfundimtare për subjektet e shpronësuar gjatë regjimit komunist. Gjykata ka konstatuar shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës, nenit 13 dhe nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës. Gjykata në vendimin pilot ka përcaktuar këto detyra për palën shqiptare:

- Hartimi i një liste të vendimeve përfundimtare gjyqësore dhe administrative që njohin, kthejnë dhe kompensojnë të drejtën e pronës ish-pronarëve. Kjo listë duhet të përmbajë të dhëna në lidhje me statusin e pronës, vendndodhjen, sipërfaqet që kthehen, kompensohen dhe format e kompensimit;

- Miratimi i hartës së vlerës së pronës me vlera sa më të arsyeshme dhe reale;

- Përgatitja e faturës financiare të procesit të kthimit dhe kompensimit të pronave;

- Krijimi i një mekanizmi efikas për ekzekutimin e të gjitha vendimeve përfundimtare, administrative dhe gjyqësore që njohin, kthejnë dhe kompensojnë pronën ish-pronarëve;

- Miratimi i një plan veprimi për ekzekutimin e vendimeve që njohin, kthejnë dhe kompensojnë pronën, me masa strategjike, strukturore, buxhetore dhe ligjore konkrete, me procedura të drejta dhe të menduara hap pas hapi, si dhe afate reale kohore.

**3. Reagimi i palës shqiptare**

Që nga momenti i hyrjes në fuqi të vendimit pilot, dhjetor 2012, dhe deri në shtator 2013, reagimi i Shqipërisë ndaj vendimit pilot ka qenë i vakët. Të vetmet masa që janë marrë deri në shtator 2013 janë ngritja e Agjencisë së Hartave Standarde të Pronësisë<sup>2</sup>, si dhe miratimi i hartës së vlerës së truallit.<sup>3</sup> Asnjë plan veprimi afatgjatë dhe gjithëpërfshirës për zbatimin e vendimit pilot nuk është hartuar deri në shtator 2013.

Qeveria e re, e dalë nga zgjedhjet e 23 qershorit 2013, u instalua në shtator 2013 dhe filloi të njihet me problematikën e pronave në përgjithësi, si dhe me problematikën e kthimit dhe kompensimit të pronave, në veçanti.

Në përputhje me angazhimin e shprehur në takimin e saj të 1186-të CM-DH, qeveria e Shqipërisë ka vendosur tashmë të përfshijë çështjet e lidhura me tokat dhe pronësinë nga gjashtë prioritetet kryesore për katër vitet e ardhshme. Kjo do të sjellë zbatimin e masave konkrete të

<sup>2</sup> Miratimi i ligji nr. 72/2012 “Mbi organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës për informacionin gjeospaciale në Republikën e Shqipërisë” për krijimin e Agjencisë për të dhënat gjeohapësinore, Miratimi i VKM nr. 147, datë 20.2.2013 i Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor” Miratimi i VKM nr. 413, datë 15.5.2013 “Për rialokimin e numrit të punonjësve dhe të fondeve buxhetore për vitin 2013, ndërmjet Institutit të Gjeografisë ushtarake dhe Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor”

<sup>3</sup> Miratimi i vendimit nr. 187, datë 6.3.2013 “Për miratimin e vlerës së pronës për secilin qark të Republikës së Shqipërisë

<sup>1</sup> Ankimet nr. 604/07, 43628/07, 46684/07 dhe 34770/09, vendimi 31.7.2012, Final me 17.12.2012

parashikuara për trajtimin e këtyre çështjeve prioritare nën mbikëqyrjen e një mekanizmi monitorues (sistemi i veçantë i njësisë së shpërndarjes), në varësi, direkte nga Kryeministri. Ky mekanizëm, i vënë në funksionim që prej muajit janar 2014, është i ngarkuar me detyrën e ndjekjes së zbatimit të gjashtë prioriteteve kryesore të qeverisë dhe i është dhënë kompetencë për të ndërhyrë nëse në këtë proces hasen probleme.

Qeveria e Republikës së Shqipërisë është në procesin e caktimit të prioriteteve afatmesme për 4 vitet e ardhshme: aktualisht është në fazat përfundimtare të miratimit të një Strategjie Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim. Në mënyrë të përmbledhur, qeveria do të krijojë 6 sektorë kryesorë/fusha prioritesh të larta ndërsektoriale dhe ndëraktive, ku “toka dhe pronat” është një prej tyre. Në të njëjtën kohë, secila ministri është duke planifikuar miratimin e 3 prioriteteve/rezultateve kryesore për t’u arritur në afatin 4-vjeçar; prezantimi i një mekanizmi efektiv kompensimi për kthimin ose kompensimin e pronave do të jetë një prej tri prioriteteve kryesore të Ministrisë së Drejtësisë.

Për të garantuar arritjen e progresit dhe rezultateve në 6 sektorët kryesorë prioritarë, një mekanizëm monitorues (që i korrespondon modelit të njësisë së shpërndarjes) është krijuar tashmë në Kryeministri<sup>4</sup> për të zgjidhur çdo problem të mundshëm dhe për të arritur objektivat e caktuar në 6 fusha prioritare, duke përfshirë “tokën dhe pronat”. Ekzistojnë njësi shpërndarjeje në secilën ministri (si në Ministrinë e Drejtësisë), të cilat ndjekin progresin në lidhje me tri prioritete ministeriale.

Në të njëjtën kohë, në dhjetor 2013, qeveria vuri në funksionim një grup pune ndërministror për përgatitjen e një plani veprimi për ekzekutimin e vendimeve në çështjen Manushaqe Puto dhe grupin e çështjeve Driza.

Grupi i punës mbledh përfaqësues nga të gjitha institucionet dhe ministratë e përfshira në procesin e kthimit/kompensimit: drejtohet nga zëvendësministri i Drejtësisë, z. Ildir Peci, më tej, ka në përbërje të tij zëvendësministrin e Financave, zëvendësministrin e Punëve të Brendshme, zëvendësministrin e Zhvillimit Ekonomik, zëvendësministrin e Ministrisë së Tregtisë dhe Sipërmarrjes, përfaqësues nga zyra e Kryeministrit, Avokatin e Përgjithshëm të Shtetit, drejtoreshën e Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (AKKP), drejtorin e Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale (ALUIZNI), drejtorin e përgjithshëm të Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP). Grupi i punës e ka përmbushur këtë detyrë brenda një periudhe prej më pak se dy muajsh (31 dhjetor 2013 - 24 shkurt 2014). Gjatë përgatitjes së plan veprimit, grupi i punës është asistuar nga Departamenti i Ekzekutimit të Vendimeve të Gjykatës Europiane për të

Drejtat e Njeriut, të Këshillit të Europës, me anë të videokonferencave, si dhe me anë të takimeve dhe diskutimeve gjatë misionit të delegacionit në datat 13-14 shkurt 2014. Qeveria shqiptare gjen rastin dhe falënderon Sekretariatit e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës për mbështetjen e vazhdueshme në këtë drejtim.

#### 4. Objektivi

Krijimi i një mekanizmi të ri efikas për kompensimin e subjekteve të shpronësuara gjatë regjimit komunist që disponojnë vendime përfundimtare për njohjen e së drejtës së kompensimit për pronën.

#### 5. Masat kryesore

- reforma institucionale;
- identifikimi i faturës financiare;
- inventarizimi i pronave të disponueshme për kompensim në natyrë;
- ndryshime legjislative në fushën e pronave për krijimin e një mekanizmi efektiv kthimi/kompensimi;
- përfundimi i regjistrimit fillestar të pronave;
- koordinimi institucional.

#### 5.1 Reforma institucionale e AKKP-së

Qeveria synon të reformojë Agjencinë për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave (AKKP), e cila do të luajë rol kryesor në mekanizmin e ardhshëm të kthimit/kompensimit. Reformat priten të përfundojnë në vitin 2015.

Qëllimi i kësaj reforme është përmirësimi dhe koordinimi i menaxhimit të pronave shtetërore që do të përdoren në procesin e kompensimit dhe për shmangien e mbivendosjes së burimeve të përfshira. AKKP-ja do të shndërrohet në Agjenci të Fondit të Tokës dhe do të menaxhojë fondin e tokës që do të shërbejë për kompensim. Për shkak të rolit të rëndësishëm të parashikuar për agjencinë e re në mekanizmin e ri të kthimit/kompensimit, propozimi është që strategjikisht të kalojë në varësi të Këshillit të Ministrave/Kryeministrit.

Me qëllim kryerjen e reformës, është e nevojshme të shtyhet mandati i AKKP-së në një vit, pasi aktualisht ai zyrtarisht skadon në muajin maj 2014<sup>5</sup>. Shtyrja njëvjeçare do të shërbejë si një periudhë e përkohshme për kryerjen e reformës ligjore dhe institucionale.

Reforma do të kryhet në disa hapa të ndërmjetëm.

5.1.a. Skanimi i gjendjes aktuale të AKKP-së dhe identifikimi i faturës të kompensimit

- *Krijimi i regjistrimit elektronik i vendimmarrjes së AKKP-së.* Është ngritur grupi i punës në AKKP me urdhër të drejtorit të përgjithshëm në nëntor 2013. Krijohet baza e saktë e të dhënave për çdo dosje në arkivin e AKKP-së. Regjistri elektronik përfundon në shtator 2014.

<sup>4</sup> Urdhri i Kryeministrit nr. 204, datë 1. 11. 2013, “Mbi strukturën dhe organizimën e Kryeministrisë”

<sup>5</sup> Neni 24 i ligjit nr. 9235 i datës 29 korrik 2004, “Mbi kthimin dhe kompensimin e pronave” parashikon se procesi i njohjes, kthimit dhe kompensimit të pronave të paluajtshme do të përfundojë më 30 prill 2014, përveç pagesës së kompensimit që do të kryhet në vitin 2015 (data e saktë nuk parashikohet në ligj). Kjo do të thotë se mandati i AKKP-së do të përfundojë në datën 1 maj 2014.

- *Krijimi i database të përfituesve nga fondi i kompensimit financiar për periudhën 2005-2012.* Përfunduar në dhjetor 2013 dhe azhurnohet çdo vit.

- *Identifikimi i institucioneve që tjetërsojnë pronën shtetërore dhe procedurat ligjore të ndjekura prej tyre.* Është ngritur grupi i punës në AKKP me urdhër të drejtorit të përgjithshëm në nëntor 2013. AKKP-ja prezanton propozimet e veta në mars 2014. Lehtësohen dhe unifikohen procedurat ndërmjet institucioneve në fushën e pronave.

- *Përpunimi i hartës së vlerës së tokës për vitin 2014, në mënyrë që të reflektojë vlerën aktuale të tregut të pronave.* Përpunohen të gjitha të dhënat për transaksionet e regjistruara në ZRPP me qëllim përgatitjen e vlerës së tokës për çdo zonë kadastrale.

#### 5.1.b. Zgjatja e afatit të AKKP-së

- *Propozim për shtyrjen e mandatit të AKKP-së.* Në shkurt 2014, AKKP-ja ka depozituar në Ministrinë e Drejtësisë propozimin për shtyrjen e mandatit.

- *Projektligj për shtyrjen e mandatit të AKKP-së.* Ministria e Drejtësisë drafton projektligjin përkatës dhe e dërgon në Këshillin e Ministrave për shqyrtim dhe miratim brenda datës 10 mars 2014.

- *Dërgimi në Kuvend i projektligjit për shtyrjen e mandatit.* Këshilli i Ministrave dërgon për shqyrtim dhe miratim në Kuvend projektligjin përkatës në gjysmën e dytë të muajit prill 2014.

- *Shqyrtimi dhe miratimi i projektligjit nga Kuvendi.* Kuvendi shqyrton projektligjin në komisionet parlamentare përkatëse në konsultim me grupet e interesit dhe kalon për miratim në seancë plenare në prill 2014.

5.1.c. Analiza e ligjit organik dhe akteve nënligjore për organizimin dhe funksionimin e AKKP-së

Në nëntor 2013 është ngritur grupi i punës në AKKP me urdhër të drejtorit të përgjithshëm, me qëllim propozime konkrete për përmirësimin e kuadrit ligjor. Propozimet e AKKP-së duhet të shqyrtohen në muajin maj 2014 nga grupi i punës për analizën e legjislacionit në fushën e pronave sipas pikës 5.4.a., si më poshtë.

#### 5.2 Identifikimi i faturës financiare

Me qëllim krijimin e një mekanizmi efektiv kthimi/kompensimi, autoritetet duhet të kenë një faturë të saktë kompensimi që rrjedh nga shuma totale e dhënë nga vendimet ekzistuese të kthimit/kompensimit. Inventarizimi i këtyre vendimeve ka mbetur pezull për një kohë shumë të gjatë. Kohët e fundit, AKKP-ja ia ka arritur të luftojë këtë problem, duke përfunduar një projekt pilot për digjitalizimin (shihni më poshtë).

Më konkretisht, autoritetet kanë marrë/parashikuar marrjen e hapave të mëposhtëm:

5.2.a. Projekti pilot për krijimin e *databases* dhe pozicionimit hartografik të vendimeve për kthimin dhe kompensimin nga viti 1993 deri tani. Projekti është zbatuar nga 6 (nga 90) anëtarë të personelit të AKKP-së nëpërmjet

përdorimit të softuerit të vënë në dispozicion për gjykim nga një shoqëri digjitale në fushën e krijimit të hartave. Projekti filloi në muajin nëntor 2013 dhe përfundoi në prill 2014. Projekti kryen një inventar të të gjitha vendimeve për kthim dhe kompensim në rajonin e Vlorës. Projekti i ka dhënë AKKP-së informacion të saktë mbi faturën e kompensimit në këtë rajon.

5.2.b. Krijimi i *databases* dhe pozicionimit hartografik të vendimeve të kthimit dhe kompensimit nga viti 1993 deri tani në të gjithë Shqipërinë. Përvoja me rajonin e Vlorës tregon se ky projekt duhet të shtrihet në të gjithë Shqipërinë. Kjo do të realizohet njëkohësisht me inventarizimin dhe digjitalizimin e rreth 46,000 dosjeve të ruajtura në arkivin e AKKP-së që prej vitit 1993. Do të mundësohet llogaritja e faturës së kompensimit për të gjithë territorin e Shqipërisë në mënyrë efektive dhe të shpejtë. Për më tepër, do të lehtësojë përzgjedhjen e formave të kompensimit. Aplikimi mund të jetë i aksesueshëm *online* nga të gjitha institucionet e interesuara dhe publiku. Kjo krijon besimin publik dhe çon në një proces transparent vendimmarrjeje.

Po zhvillohen bisedime me BE-në, me qëllim mundësimin e alokimit të një fondi prej 1 milion euro (fondet IPA) për zbatimin e këtij projekti. Ky fond pritet të jepet brenda muajit qershor 2014. Projekti i plotë do të finalizohet brenda 12 muajve nga momenti i alokimit të tij.

5.3 Inventarizimi i pronave të vëna në dispozicion për kompensimin në natyrë

Autoritetet shqyrtojnë inventarin e burimeve të disponueshme të tokës së bashku me përcaktimin e faturës financiare të kompensimit që do të jetë thelbësore për caktimin e nivelit të saktë dhe formave të kompensimit që do të jepen përfundimisht nëpërmjet mekanizmit të ri të kthimit/kompensimit. Autoritetet synojnë të përfundojnë inventarin e pronave të vëna në dispozicion për kompensimin në natyrë deri në muajin tetor 2014.

Më konkretisht, dy grupe ndërminstrore që janë krijuar pranë Kryeministrit në prill 2014, përkatësisht do të identifikojnë pronat shtetërore të vëna në dispozicion për kompensim në natyrë dhe do të verifikojnë statusin aktual ligjor të tokës që tashmë është shpërndarë për këtë qëllim tek AKKP-ja.

#### 5.4 Ndryshimet legjislative në fushën e pronësisë

Kjo masë e favorshme për funksionimin e mekanizmit të ri efektiv të kthimit/kompensimit, synon të shmangë fragmentimin e ligjit, duke garantuar siguri juridike, mjete efektive apeli dhe lehtësim të procedurave të kompensimit.

Procesi legjislativ duhet të përfundojë maksimumi në qershor 2015 dhe konsultimet publike do të zhvillohen në çdo hap kryesor të tij.

Me qëllim arritjen e këtij objektiv, janë marrë hapat e mëposhtëm:

#### 5.4.a. Analiza e legjislacionit për pronësinë

Me urdhër të Kryeministrit ngrihet një grup pune

ndërinstitucional me ekspertë nga Ministria e Drejtësisë, Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit (ALUIZNI), AKKP, ZRPP, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Mjedisit, Ministria e Bujqësisë, Ministria e Ekonomisë dhe Ministria e Financave. Grupi i punës do të koordinohet nga Ministria e Drejtësisë. Grupi do të marrë në analizë ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi për kthimin dhe kompensimin e pronave<sup>6</sup>, për legalizimin,<sup>7</sup> për regjistrimin e pasurive të paluajtshme<sup>8</sup>, si dhe për pronat e paluajtshme të shtetit,<sup>9</sup> dhe akteve ligjore për metodologjinë për hartën e vlerës së tokës. Analiza vlerëson ndërhyrjet konkrete në legjislacion. Ky proces përfundon në muajin qershor 2014.

#### 5.4.b. Konsultim paraprak

Përfundimet e analizës së mësipërme i nënshtrohen një procesi konsultimi paraprak me grupet e interesit me qëllim grumbullimin e mendimeve të tyre për draftimin paraprak të ndërhyrjeve në legjislacion. Kjo rrit besimin e publikut dhe realizimin e një procesi transparent në vendimmarrje. Procesi i konsultimit paraprak përfundon në gusht 2014.

#### 5.4.c. Draftimi i ndryshimeve ligjore

Mbas procesit të konsultimit paraprak draftohen ndryshimet e nevojshme. Përgjegjës për këtë proces janë institucionet e përmendura në pikën 5.1.a. Draftimi përfundon në tetor 2014.

#### 5.4.d. Konsultim përfundimtar

Projektaktet i nënshtrohen një procesi konsultimi përfundimtar me grupet e interesit, si dhe institucionet shtetërore. Kjo rrit besimin e publikut dhe realizimin e një procesi transparent në vendimmarrje. Konsultimi përfundon në dhjetor 2014.

5.4.e. Reflektimi i sugjerimeve dhe përgatitja e draftit përfundimtar

Mbas konsultimit përfundimtar reflektohet mbi vërejtjet dhe sugjerimet e dala nga ky proces, si dhe përgatitet projekti përfundimtar. Projektaktet përfundimtare dërgohen për shqyrtim dhe miratim në Këshillin e Ministrave në shkurt 2015.

#### 5.4.f. Paraqitja dhe miratimi nga Parlamenti

Këshilli i Ministrave do të rishikojë, do të miratojë dhe do të dërgojë në Parlament projektligjet në mars 2015. Parlamenti do të fillojë procesin e konsultimit publik dhe do të zhvillojë sesionin plenar për miratimin e projektligjeve brenda periudhës prill - qershor 2015.

#### 5.5 Përfundimi i regjistrimit fillestar të pasurive

Nëse mekanizmi i ri i kthimit/kompensimit parashikon kompensimin në natyrë si një prej formave të kompensimit, mirëfunksionimi i tij do të varet nga saktësia e sistemit të regjistrimit të pronave të paluajtshme. Për këtë

qëllim, autoritetet janë caktuar të përfundojnë, deri në fund të vitit 2016, regjistrimin fillestar të pronave për pjesën e mbetur të zonave kadastrale të paregjistruara.

Deri tani ka përfunduar regjistrimi i 2,584 nga një numër total prej 3,057 zonash kadastrale. Ky regjistrim është duke u kryer në 119 zona kadastrale të tjera me fondet e Bankës Botërore sipas projektit LAMP dhe pritet të përfundojë për 354 zonat kadastrale të tjera deri në fund të vitit 2016, financuar nga të ardhurat e ZRPP-së që, sipas llogaritjeve paraprake, arrijnë 1,570,000,000 lekë (rreth 11,000,000 euro).

#### 5.6 Koordinimi institucional

Një prej problemeve të vërejtura gjatë 20 viteve të fundit ka qenë mungesa e bashkëpunimit efektiv ndërmjet institucioneve përkatëse në fushën e të drejtave të pronësisë. Kjo ka çuar në vonesa të pajustificueshme për përfundimin e suksesshëm të procesit të kthimit dhe kompensimit të pronave. Për më tepër, mungesa e koordinimit ka kontribuar në pasigurinë juridike. Duke nxjerrë konkluzione nga kjo përvojë negative, qeveria shqiptare mori përsipër të garantojë koordinimin institucional me qëllim garantimin e zbatimit të suksesshëm të planit të veprimit.

Nga koha e formimit të qeverisë së re në shtator 2013, janë marrë masat e mëposhtme për arritjen e këtij objekti:

5.6.a. Grupi ndërinstitucional i punës për marrjen e masave për zbatimin e vendimit pilot “Manushaqe Puto e të tjerë kundër Shqipërisë” dhe vendimet e grupit Driza të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Grupi i punës është krijuar në bazë të urdhrimit të Kryeministrit në dhjetor 2013 dhe do të përfundojë punën e tij në muajin shkurt 2014.

5.6.b. Grupi ndërinstitucional i punës për identifikimin e problemeve dhe përmirësimeve të nevojshme të procedurave ligjore të lidhura me shpërndarjen e certifikatave të pronësisë për tokën bujqësore. Grupi i punës është krijuar me urdhër të Kryeministrit në dhjetor 2013 dhe do të përfundojë punën e tij në maj 2014.

5.6.c. Komiteti Ndërminstros për iniciativën dhe koordinimin e procesit të hartimit të një plani kombëtar gjithëpërfshirës. Komiteti i drejtuar nga Kryeministri u krijua në nëntor 2013 dhe mblidhet rregullisht çdo muaj.

5.6.d. Projekti pilot për aksesin *online* të AKKP-së dhe ALUIZNI-t në sistemin digjital të ZQRPP-së për zonat kadastrale të regjistruara në sistem. Projekti synon uljen, lehtësimin dhe eliminimin e burokracisë në procedurat e verifikimit të statusit ligjor të pronave gjatë aktivitetit të agjencive përkatëse. Projekti filloi në janar 2014 dhe është në fazën pilot, e cila do të përfundojë në maj 2014.

5.6.e. Grupi ndërminstros për identifikimin dhe verifikimin e fondit të tokës bujqësore i vënë në dispozicion për AKKP-në për kompensimin në natyrë. Grupi është krijuar me urdhër të Kryeministrit në prill 2014 për një kohëzgjatje prej gjashtë muajsh.

<sup>6</sup> Ligji nr. 9235, datë 29.7.2004, “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, i ndryshuar

<sup>7</sup> Rregullohet nga ligji 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar

<sup>8</sup> Ligji nr. 33/2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”

<sup>9</sup> Ligji nr. 8743, datë 22.2.2001.

5.6.f. Grupi ndërmintor për përmirësimin e situatës legjislative në fushën e pronave. Grupi është krijuar me urdhër të Kryeministrit në muajin prill 2014 (shihni objektivin 5.4.a).

5.6.g. Grupi ndërmintor për identifikimin e pronës shtetërore që do të përdoret për kompensimin në natyrë. Grupi është krijuar me urdhër të Kryeministrit në prill 2014.

#### 6. Konkluzion

Qeveria çmon se masat e lartpërmendura janë një reagim i përshtatshëm dhe gjithëpërfshirës ndaj thirrjeve të Komitetit të Ministrave për një mekanizëm efektiv kthimi/kompensimi për pronat e konfiskuara gjatë regjimit komunist, të cilat duhet të vihen në funksionim në Shqipëri. Afatet e caktuara nga plani i veprimit për secilën prej këtyre masave dhe për hapat e ndërmjetëm do t'i japin mundësinë Komitetit të Ministrave të Këshilli të Europës të ushtrojë siç duhet misionin e tij të mbikëqyrjes së zbatimit të vendimeve të Gjykatës Europiane, në çështjen Manushaqe Puto dhe në çështjet e grupit Driza.

Autoritetet janë të mirinformuara se shumica e këtyre afateve janë jashtë afatit të përcaktuar nga Gjykata Europiane në vendimin pilot të Manushaqe Puto për

rivendosijen e mekanizmit të ri të kthimit/kompensimit dhe do ta trajtojnë këtë me Sekretarinë e Gjykatës Europiane. Megjithatë, ata konsiderojnë se këto afate janë realiste dhe parashikojnë një perspektivë të qartë për zgjidhjen përfundimtare të çështjeve në fjalë.

Autoritetet besojnë se një shqyrtim i këtyre çështjeve në mbledhjen e CM DH-së të qershorit 2014 do t'i jepte mundësinë Komitetit të Ministrave të vlerësojë zbatimin e hapave të ndërmjetëm që duhet të përmbushen deri në atë kohë, në bazë të informacionit të përditësuar që do të transmetohet në kohën e duhur, dhe për autoritetet, për të demonstruar se vendosmëria e tyre për të arritur një zgjidhje përfundimtare të këtyre çështjeve është përkthyer në rezultate konkrete.

Së fundi, por jo më pak e rëndësishmja, autoritetet do të vazhdojnë të bashkëpunojnë ngushtë me Departamentin e Ekzekutimit/Zbatimit për të shpjeguar ndonjë çështje të pazgjidhur që mund të identifikohet në planin e veprimit, ndërsa ata synojnë të shfrytëzojnë ndonjë ekspertizë që Sekretariati dhe/ose organet e tjera të Këshillit të Europës mund të ofrojnë, në përpjekjet e tyre për t'i dhënë fund këtij problemi që ka vazhduar prej një kohe të gjatë.

#### Objektivi 1. Reforma institucionale e AKKP-së

Nr.	Masat/aktivitete	Institucioni përgjegjës	Kostoja	Burimet	Afati	Komente
1.1	Skanimi i gjendjes aktuale të AKKP-së	AKKP/Ministria e Drejtësisë			Qershor 2015	
1.1.1	Krijimi i regjistrit elektronik i vendimmarrjes së AKKP-së	AKKP			Nëntor 2013 – shtator 2014	
1.1.2	Krijimi i <i>databases</i> të përfituesve nga fondi i kompensimit financiar 2005-2012	AKKP			Dhjetor 2013 dhe azhurnohet çdo vit	
1.1.3	Identifikimi i institucioneve që tjetërsojnë pronën shtetërore dhe procedurat ligjore të ndjekura prej tyre	AKKP			Mars 2014	Lehtësimi dhe unifikimi i procedurave ndërmjet institucioneve që veprojnë në fushën e pronësisë
1.1.4	Përpunimi i hartës së vlerës së tokës për vitin 2014	AKKP			Mars/prill 2014	
1.1.5	Projekti pilot për krijimin e <i>databases</i> dhe pozicionim hartografik të vendimeve për kthim dhe kompensim 1993 dhe në vazhdim për qarkun e Vlorës	AKKP			Nëntor 2013 - prill 2014	Softi i dhuruar nga kompani digjitale hartash; Në përfundim të projektit ka informacion të saktë mbi faturën e kompensimit në këtë qark
1.1.6	Krijimi i <i>databases</i> dhe pozicionimit hartografik të vendimeve për kthim dhe kompensim nga viti 1993 deri më sot në gjithë territorin e Shqipërisë	AKKP	1 milion euro	Negociata me (BE) për akordimin e fondit nga projektet IPA	Qershor 2014 - qershor 2015	Llogaritet fatura e kompensimit në të gjithë territorin e Republikës në mënyrë efikase dhe të shpejtë
1.2	Zgjatja e afatit të AKKP-së	AKKP/ Ministria e Drejtësisë /Këshilli i Ministrave/Kuvendi			Mars 2014 - prill 2014	
1.2.1	Propozim për shtyrjen e mandatit të AKKP-së	AKKP			Mars 2014	
1.2.2	Projektligj për shtyrjen e mandatit të AKKP-së	Ministria e Drejtësisë/			10 mars 2014	

		Këshilli i Ministrave				
1.2.3	Dërgimi në Kuvend i projektligjit për shtyrjen e mandatit	Këshilli i Ministrave			Prill 2014	
1.2.4	Shqyrtimi dhe miratimi i projektligjit	Kuvendi i Shqipërisë			Prill 2014	Konsultimi me grupet e interesit
1.3	Analiza e ligjit organik dhe akteve nënligjore për organizimin dhe funksionimin e AKKP-së	AKKP			Nëntor 2013 – prill 2014	Paraqet propozime konkrete grupit të punës ndërinstytucional (për çështjet e pronësisë) të parashtruar në pikën 2.1.1

## Objektivi 2. Përmirësimi i situatës legjislativë në fushën e pronave

Nr.	Masat/aktivitete	Institucioni përgjegjës	Kostoja	Burimet	Afati	Komente
2.1	Analiza e legjislacionit për pronësinë	Kryeministria Ministria e Drejtësisë Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit (ALUIZNI) AKKP ZRPP Ministria e Punëve të Brendshme Ministria e Mjedisit Ministria e Bujqësisë Ministria e Ekonomisë Ministria e Financave			Prill 2014-qershor 2014	
2.1.1	Ngritja e grupit të punës me urdhër të Kryeministrit për rishikim të legjislacionit në fuqi për pronat	Kryeministria			17 prill 2014	Pjese e grupit të punës: Ministria e Drejtësisë Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit (ALUIZNI) AKKP ZRPP Ministria e Punëve të Brendshme Ministria e Mjedisit Ministria e Bujqësisë Ministria e Ekonomisë Ministria e Financave
2.1.2	Analizë e legjislacionit për pronësinë	Grupi i punës			Prill - qershor 2014	
2.2	Konsultimi paraprak me grupet e interesit	Në varësi të ligjeve që ndryshohen do ngarkohen institucionet përgjegjëse			Gusht 2014	
2.2.1	Organizimi i tryezave të rrumbullakëta me shoqatat e ndryshme përfaqësuese të subjekteve të shpronësuar gjatë regjimit komunist, shoqëria civile etj.	Institucionet përgjegjëse			Qershor – gusht 2014	Në varësi të ligjeve që ndryshohen do të ngarkohen institucionet përgjegjëse
2.3	Draftimi i ndryshimeve ligjore	Institucionet përgjegjës/Ministria e Drejtësisë			Tetor 2014	Në varësi të ligjeve që ndryshohen do të ngarkohen institucionet përgjegjëse në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë



2.4	Konsultimi përfundimtar me grupet e interesit	Në varësi të ligjeve që ndryshohen do të ngarkohen institucionet përgjegjëse			Dhjetor 2014	
2.4.1	Organizimi i tryezave të rrumbullakëta me shoqatat e ndryshme përfaqësuese të subjekteve të shpronësuara gjate regjimit komunist, shoqëria civile etj.	Në varësi të ligjeve që ndryshohen do të ngarkohen institucionet përgjegjëse			Tetor 2014 - dhjetor 2014	
2.5	Reflektimi i sugjerimeve dhe përgatitja e draftit përfundimtar	Në varësi të ligjeve që ndryshohen do të ngarkohen institucionet përgjegjëse në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë			Shkurt 2015	
2.5.1	Dërgimi për shqyrtim i projektakteve përfundimtare në Këshillin e Ministrave	Ministria e Drejtësisë			Shkurt 2015	
2.6	Dërgimi dhe miratimi në Kuvend projektakteve	Këshilli i Ministrave/Kuvendi			Mars 2015 – qershor 2015	
2.6.1	Shqyrtimi, miratimi dhe dërgimi i projektakteve në Kuvend	Këshilli i Ministrave			Mars 2015	
2.6.2	Konsultimi publik dhe miratimi në seancë plenare i projektakteve	Kuvendi i Shqipërisë			Prill-qershor 2015	

### Objektivi 3. Bashkërendimi institucional

Nr.	Masat/aktivitete	Institucioni përgjegjës	Kostoja	Burimet	Afati	Komente
3.1	Grupi ndërinstitutional i punës për marrjen e masave për zbatimin e vendimit pilot “Manushaqe Puto etj. kundër Shqipërisë” dhe vendimeve të “Grupit Driza” të GJEDNJ-së	Me urdhër të Kryeministrit			Dhjetor 2013 - shkurt 2014	
3.2	Grupi ndërinstitutional i punës për evidentimin e problematikave dhe përmirësimet e nevojshme të procedurave ligjore për shpërndarjen e certifikatave të pronësisë mbi tokën bujqësore	Me urdhër të Kryeministrit			Dhjetor 2013 - maj 2014	
3.3	Ngritja e Komitetit Ndërmintor për nismën dhe bashkërendimin e procesit për hartimin e planit të përgjithshëm kombëtar	Kryesohet nga Kryeministri			Nëntor 2013- vazhdon çdo 1 herë në muaj	
3.4	Projektpilot për aksesimin online të AKKP-së dhe ALUIZNI-t në sistemin digjital të ZQRPP-së për zonat kadastrale të hedhura në sistem	AKKP, ALUIZNI, ZRPP			Janar 2014 – maj 2014	
3.5	Grupi ndërministrior për identifikimin dhe verifikimin e fondit të	Kryeministria/ Ministria e Bujqësisë /			Prill 2014 - tetor 2014	

	tokës bujqësore vënë në dispozicion AKKP-së për efekt të kompensimit fizik	Ministria e Brendshme				
3.6	Grupi ndërinstitucional për përmasimin e situatës legjislative në fushën e pronave sipas pikës 2.1.1	Kryeministria			17 prill 2014	Pjesë e grupit të punës: Ministria e Drejtësisë Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit (ALUIZNI) AKKP ZRPP Ministria e Punëve të Brendshme Ministria e Mjedisit Ministria e Bujqësisë Ministria e Ekonomisë Ministria e Financave
3.7	Grupi ndërinstitucional për identifikimin e pronës shtetërore për përdorim kompensim fizik	Kryeministria			17 prill 2014	Pjesë e grupit të punës: Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit (ALUIZNI) AKKP ZRPP Ministria e Punëve të Brendshme Ministria e Mjedisit Ministria e Bujqësisë Ministria e Ekonomisë Ministria e Financave Ministria e Mbrojtjes

## Objektivi 4. Përfundimi i regjistrimit fillestar të pronave

Nr.	Masat/aktivitete	Institucioni përgjegjës	Kostoja	Burimet	Afati	Komente
4.1	Përfundimi i regjistrimit fillestar	ZQRPP	1,570.00 0,000.00 ALL	Fondet e Bankës Botërore në kuadër të projektit LAMP	Fundi i viti 2016	
4.2	Procesi i përmirësimit dhe përditësimit të të dhënave digjitale të regjistrimit fillestar	ZQRPP		Banka Botërore, Bashkimi Europian në kuadër të projektit LADI, si dhe nga të ardhurat e ZRPP-së	2014-2018	

## Objektivi 5. Rishikimi i formulës dhe formave të kompensimit

Nr.	Masat/aktivitete	Institucioni përgjegjës	Kostoja	Burimet	Afati	Komente
5.1	Sigurimi i një formule realiste kompensimi	AKKP/ Ministria e Drejtësisë/ Ministria e Financave/ Ministria e Financave/ Ministria e Bujqësisë/ Ministria e Mjedisit	Për t'u përcaktuar në fund të procesit		Mbas realizimit të objektivave dhe masave të mësipërme	Realizimi i këtij objektivi mund të bëhet vetëm pasi është përlogaritur fatura e kompensimit nga njëra anë dhe inventarizimi i aseteve shtetërore nga ana tjetër

**VENDIM**  
**Nr. 237, datë 23.4.2014**

**PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË ORGANIKËS SË POLICISË SË MBROJTJES NGA ZJARRI DHE TË SHPËTIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4 të nenit 2 të ligjit nr. 8766, datë 5.4.2001, "Për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Numri limit i punonjësve të shërbimit të PMNZSH-së pranë prefektit të qarkut të jetë, gjithsej,

739 veta, sipas lidhjes nr. 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Vendimi nr. 646, datë 30.9.2004, i Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit", i ndryshuar, shfuqizohet.

3. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme dhe prefekti i qarkut për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**

**Lidhja nr. 1**

**STRUKTURA DHE LIMITI ORGANIK I SEKTORIT TË PMNZSH-së TË PREFEKTIT TË QARKUT**  
**1**

**1. Struktura organike e sektorit të PMNZSH-së në Institucionin e Prefektit të qarkut Tiranë**

a) Shef sektori i PMNZSH-së së qarkut (niveli i lartë)	1
b) Shef i zyrës së inspektim-parandalimit (niveli i mesëm)	1
c) Inspektor parandalimi (niveli i mesëm)	2
d) Ekonomiste (niveli i mesëm)	1
e) Magazinier & portokollist-arkivist (niveli bazë)	1
f) Sanitare (civil)	1
	<b>7</b>

**1.1 Stacioni i PMNZSH-së nr. 1 "21 Dhjetori"**

a) Komandant i stacionit (niveli i mesëm)	1
b) Punonjës informacioni (niveli bazë)	4
c) Përgjegjës shërbimi (niveli bazë)	4
d) Personel zjarrfikës, operues, luftues (niveli bazë)	16
e) Personel drejtimi automjetesh (niveli bazë)	12
	<b>37</b>

**1.2 Stacioni i PMNZSH-së nr. 2 "Kombinat"**

a) Komandant stacioni, inspektor parandalimi (niveli i mesëm)	1
b) Inspektor parandalimi (niveli bazë)	1
c) Personel zjarrfikës, luftues (niveli bazë)	8
d) Personel drejtimi automjetesh zjarrfikëse (niveli bazë)	4
	<b>14</b>

**1.3 Stacioni i PMNZSH-së nr. 3 "Kamëz"**

a) Komandant stacioni, inspektor parandalimi (niveli i mesëm)	1
b) Inspektor parandalimi (niveli bazë)	1
c) Personel zjarrfikës, luftues (niveli bazë)	8
d) Personel drejtimi automjetesh zjarrfikëse (niveli bazë)	4
	<b>14</b>

**1.4 Stacioni i PMNZSH-së nr. 4 "Kinostudio"**

a) Komandant stacioni, inspektor parandalimi (niveli i mesëm)	1
b) Inspektor parandalimi (niveli bazë)	1
c) Personel zjarrfikës, luftues (niveli bazë)	8
d) Personel drejtimi automjetesh zjarrfikëse (niveli bazë)	4
	<b>14</b>

**1.5 Stacioni i PMNZSH-së nr. 5 "Qyteti i Studentëve"**

a) Komandant stacioni (niveli i mesëm)	1
b) Inspektor parandalimi (niveli bazë)	1

c) Personel zjarrfikës, luftues (niveli bazë)	8
d) Personel drejtimi automjetesh zjarrfikëse (niveli bazë)	4
	<b>14</b>
<b>1.6 Stacioni i PMNZSH-së nr. 6 “Tuneli Kërrabë”</b>	
a) Komandant stacioni, inspektor parandalimi (niveli i mesëm)	1
b) Personel zjarrfikës, luftues (niveli bazë)	8
c) Personel drejtimi automjetesh zjarrfikëse (niveli bazë)	8
	<b>17</b>
<b>1.7 Stacioni i PMNZSH-së Kavajë</b>	
a) Komandant stacioni, inspektor parandalimi (niveli i mesëm)	1
b) Përgjegjës shërbimi (niveli bazë)	4
c) Personel zjarrfikës, shpëtues, luftues (niveli bazë)	8
d) Personel drejtimi automjetesh zjarrfikëse (niveli bazë)	4
	<b>17</b>
<b>GJITHSEJ PUNONJËS NË QARKUN E TIRANËS</b>	<b>133</b>
	<b>2</b>
<b>2. Struktura organike e sektorit të PMNZSH-së në Institucionin e Prefektit të qarkut Durrës</b>	
a) Shef sektori i PMNZSH-së së qarkut (niveli i lartë)	1
b) Shef zyre për parandalimin (niveli i mesëm)	1
c) Punonjës inspektimi parandalimi (niveli i mesëm)	2
d) Ekonomiste (niveli i mesëm)	1
e) Portokollist-arkivist, magazinier (niveli bazë)	1
	<b>6</b>
<b>2.1 Stacioni i PMNZSH-së Durrës qendër</b>	
a) Komandant i stacioneve (niveli i mesëm)	1
b) Punonjës informacioni (niveli bazë)	4
c) Përgjegjës shërbimi (niveli bazë)	4
d) Personel zjarrfikës, shpëtues, luftues (niveli bazë)	12
e) Personel drejtimi automjetesh zjarrfikëse (niveli bazë)	8
	<b>29</b>
<b>2.2 Stacioni i PMNZSH-së nr. 2 “Durrës-Plazh”</b>	
a) Personel zjarrfikës, shpëtues, luftues (niveli bazë)	4
b) Personel drejtimi automjetesh (niveli bazë)	4
	<b>8</b>
<b>2.3 Stacioni i PMNZSH-së Krujë</b>	
a) Komandant stacioni, inspektor parandalimi (niveli i mesëm)	1
b) Personel zjarrfikës, shpëtues, luftues (niveli bazë)	8
c) Personel drejtimi automjetesh zjarrfikëse (niveli bazë)	4
	<b>13</b>
<b>GJITHSEJ PUNONJËS NË QARKUN E DURRËSIT</b>	<b>56</b>
	<b>3</b>
<b>3. Struktura organike e sektorit të PMNZSH-së në Institucionin e Prefektit të qarkut Fier</b>	
a) Shef sektori i PMNZSH-së së qarkut (niveli i lartë)	1
b) Shef zyre për parandalimin (niveli i mesëm)	1
c) Punonjës inspektimi parandalimi (niveli i mesëm)	2
d) Ekonomiste (niveli i mesëm)	1
e) Portokollist-arkivist & magazinier (niveli bazë)	1
	<b>6</b>
<b>3.1 Stacioni i PMNZSH-së Fier qendër</b>	
a) Komandant i stacioneve (niveli i mesëm)	1
b) Punonjës informacioni (niveli bazë)	4
c) Përgjegjës shërbimi (niveli bazë)	4
d) Personel zjarrfikës, shpëtues, luftues (niveli bazë)	8

e) Personel drejtimi automjetesh zjarrfikëse (niveli bazë)	8
	<b>25</b>

**3.2 Stacioni i PMNZSH-së Patos**

a) Komandant stacioni, inspektor parandalimi (niveli bazë)	1
b) Personel zjarrfikës, shpëtues, luftues (niveli bazë)	4
c) Personel drejtimi automjetesh zjarrfikëse (niveli bazë)	4
	<b>9</b>

**3.3 Stacioni i PMNZSH-së Ballsh**

a) Komandant stacioni, inspektor parandalimi (niveli bazë)	1
b) Personel zjarrfikës, shpëtues, luftues (niveli bazë)	4
c) Personel drejtimi automjetesh zjarrfikëse (niveli bazë)	4
	<b>9</b>

**3.4 Stacioni i PMNZSH-së Lushnjë**

a) Komandant stacioni, inspektor parandalimi (niveli i mesëm)	1
b) Përgjegjës shërbimi (niveli bazë)	4
c) Personel zjarrfikës, shpëtues, luftues (niveli bazë)	4
d) Personel drejtimi automjetesh zjarrfikëse (niveli bazë)	4
	<b>13</b>

**GJITHSEJ PUNONJËS NË QARKUN E FIERIT** **61**

4

**4. Struktura organike e sektorit të PMNZSH-së në Institucionin e Prefektit të qarkut Berat**

a) Shef sektori i PMNZSH-së së qarkut (niveli i lartë)	1
b) Shef zyre për parandalimin (niveli i mesëm)	1
c) Punonjës parandalimi (niveli bazë)	2
d) Ekonomiste (niveli i mesëm)	1
e) Portokollist-arkivist & magazinier (niveli bazë)	1
	<b>6</b>

**4.1 Stacioni i PMNZSH-së Berat qendër**

a) Komandant stacioni (niveli i mesëm)	1
b) Punonjës informacioni (niveli bazë)	4
c) Përgjegjës shërbimi (niveli bazë)	4
d) Personel zjarrfikës, shpëtues, luftues (niveli bazë)	8
e) Personel drejtimi automjetesh zjarrfikëse (niveli bazë)	8
	<b>25</b>

**4.2 Stacioni i PMNZSH-së Kuçovë**

a) Komandant stacioni, inspektor parandalimi (niveli i mesëm)	1
b) Përgjegjës shërbimi (niveli bazë)	4
c) Personel zjarrfikës, shpëtues, luftues (niveli bazë)	4
d) Personel drejtimi automjetesh zjarrfikëse (niveli bazë)	4
	<b>13</b>

**4.3 Stacioni i PMNZSH-së Skrapar**

a) Komandant stacioni, inspektor parandalimi (niveli bazë)	1
b) Personel zjarrfikës, shpëtues, luftues (niveli bazë)	4
c) Personel drejtimi automjetesh zjarrfikëse (niveli bazë)	4
	<b>9</b>

**4.4 Stacioni i PMNZSH-së Poliçan**

a) Personel shofer, luftues, zjarrfikës	4
---	---

**GJITHSEJ PUNONJËS NË QARKUN E BERATIT** **57**

5

**5. Struktura organike e sektorit të PMNZSH-së në Institucionin e Prefektit të qarkut Vlorë**

a) Shef sektori i PMNZSH-së së qarkut (niveli i lartë)	1
b) Shef zyre për parandalimin (niveli i mesëm)	1

c) Punonjës parandalimi (niveli i mesëm)	2
d) Ekonomiste (niveli i mesëm)	1
e) Portokollist-arkivist & magazinier (niveli bazë)	1
	<b>6</b>

**5.1 Stacioni i PMNZSH-së Vlorë**

a) Komandant stacioni dhe stërvitjes (niveli mesëm)	1
b) Punonjës informacioni (niveli bazë)	4
c) Përgjegjës shërbimi (niveli bazë)	4
d) Personel zjarrfikës, shpëtues, luftues (niveli bazë)	12
e) Personel drejtimi automjetesh zjarrfikëse (niveli bazë)	8
	<b>29</b>

**5.3 Stacioni i PMNZSH-së Sarandë**

a) Komandant stacioni, inspektor parandalimi (niveli i mesëm)	1
b) Përgjegjës shërbimi (niveli bazë)	4
c) Personel zjarrfikës, shpëtues, luftues (niveli bazë)	8
d) Personel drejtimi automjetesh zjarrfikëse (niveli bazë)	4
	<b>17</b>

**5.4 Stacioni i PMNZSH-së Delvinë**

a) Komandant stacioni inspektor parandalimi (niveli i mesëm)	1
b) Personel zjarrfikës, shpëtues, luftues (niveli bazë)	4
c) Personel drejtimi automjetesh zjarrfikëse (niveli bazë)	4
	<b>9</b>

**5.5 Stacioni i PMNZSH-së Himarë**

a) Komandant stacioni & inspektor parandalimi (niveli bazë)	1
b) Personel zjarrfikës, shpëtues, luftues (niveli bazë)	4
c) Personel drejtimi automjetesh zjarrfikëse (niveli bazë)	4
	<b>9</b>

**GJITHSEJ PUNONJËS NË QARKUN E VLORËS** **70****6****6. Struktura organike e sektorit të PMNZSH-së në Institucionin e Prefektit të qarkut Gjirokastrë**

a) Shef sektori i PMNZSH-së së qarkut (niveli i lartë)	1
b) Shef zyre për parandalimin (niveli i mesëm)	1
c) Punonjës inspektim-parandalimi (niveli bazë)	1
d) Ekonomiste (niveli i mesëm)	1
e) Portokollist-arkivist & magazinier (niveli bazë)	1
	<b>5</b>

**6.1 Stacioni i PMNZSH-së Gjirokastrë**

a) Komandant stacioni dhe stërvitjes (niveli i mesëm)	1
b) Punonjës informacioni (niveli bazë)	4
c) Përgjegjës-shërbimi (niveli bazë)	4
d) Personel zjarrfikës, shpëtues, luftues (niveli bazë)	8
e) Personel drejtimi automjetesh zjarrfikëse (niveli bazë)	8
	<b>25</b>

**6.2 Stacioni i PMNZSH-së Përmet**

a) Komandant stacioni, inspektor parandalimi (niveli bazë)	1
b) Personel zjarrfikës, shpëtues, luftues (niveli bazë)	4
c) Personel drejtimi automjetesh zjarrfikëse (niveli bazë)	4
	<b>9</b>

**6.3 Stacioni i PMNZSH-së Tepelenë**

a) Komandant stacioni inspektor parandalimi (niveli bazë)	1
b) Personel zjarrfikës, shpëtues, luftues (niveli bazë)	4
c) Personel drejtimi automjetesh zjarrfikëse (niveli bazë)	4
	<b>9</b>

**GJITHSEJ PUNONJËS NË QARKUN E GJIROKASTRËS** **48**

## 7

**7. Struktura organike e sektorit të PMNZSH-së në Institucionin e Prefektit të qarkut Korçë**

a) Shef sektori i PMNZSH-së së qarkut (niveli i lartë)	1
b) Shef zyre për parandalimin (niveli i mesëm)	1
c) Punonjës parandalimi (niveli bazë)	2
d) Ekonomiste (niveli i mesëm)	1
e) Magazinier & portokollist-arkivist (niveli bazë)	1
	<b>6</b>

**7.1 Stacioni i PMNZSH-së Korçë**

a) Komandant stacioni, dhe stërvitje (niveli i mesëm)	1
b) Punonjës informacioni (niveli bazë)	4
c) Përgjegjës-shërbimi (niveli bazë)	4
d) Personel zjarrfikës, shpëtues, luftues (niveli bazë)	8
e) Personel drejtimi automjetesh zjarrfikëse (niveli bazë)	8
	<b>25</b>

**7.2 Stacioni i PMNZSH-së Pogradec**

a) Komandant stacioni inspektor parandalimi (niveli i mesëm)	1
b) Përgjegjës-shërbimi (niveli bazë)	4
c) Personel zjarrfikës, shpëtues, luftues (niveli bazë)	4
d) Personel drejtimi automjetesh zjarrfikëse (niveli bazë)	4
	<b>13</b>

**7.4 Stacioni i PMNZSH-së Ersekë**

a) Komandant stacioni, inspektor parandalimi (niveli bazë)	1
b) Personel zjarrfikës, shpëtues, luftues (niveli bazë)	4
c) Personel drejtimi automjetesh zjarrfikëse (niveli bazë)	4
	<b>9</b>

**7.5 Stacioni i PMNZSH-së Devoll**

a) Personel zjarrfikës, shofer, shpëtues, luftues (niveli bazë)	4
	<b>4</b>

**GJITHSEJ PUNONJËS NË QARKUN E KORÇËS**

## 8

**8. Struktura organike e sektorit të PMNZSH-së në Institucionin e Prefektit të qarkut Elbasan**

a) Shef sektori i PMNZSH-së së qarkut (niveli i lartë)	1
b) Shef zyre për parandalimin (niveli i mesëm)	1
c) Punonjës parandalimi (niveli i mesëm)	2
d) Ekonomiste (niveli i mesëm)	1
e) Portokollist-arkivist & magazinier (niveli bazë)	1
	<b>6</b>

**8.1 Stacioni i PMNZSH-së Elbasan**

a) Komandant stacioni dhe stërvitjes (niveli i mesëm)	1
b) Punonjës informacioni (niveli bazë)	4
c) Përgjegjës shërbimi (niveli bazë)	4
d) Personel zjarrfikës, shpëtues, luftues (niveli bazë)	8
e) Personel drejtimi automjetesh zjarrfikëse (niveli bazë)	8
	<b>25</b>

**8.2 Stacioni i PMNZSH-së Peqin**

a) Personel zjarrfikës, shofer, shpëtues, luftues (niveli bazë)	4
	<b>4</b>

**8.3 Stacioni i PMNZSH-së Librazhd**

a) Komandant stacioni, inspektor parandalim (niveli i mesëm)	1
b) Personel zjarrfikës, shpëtues, luftues (niveli bazë)	4
c) Personel drejtimi automjetesh zjarrfikëse (niveli bazë)	4
	<b>9</b>

**8.4 Stacioni i PMNZSH-së Gramsh**

a) Komandant stacioni, inspektor parandalimi (niveli bazë)	1
b) Personel zjarrfikës, shpëtues, luftues (niveli bazë)	4
c) Personel drejtimi automjetesh zjarrfikëse (niveli bazë)	4
	<b>9</b>

**GJITHSEJ PUNONJËS NË QARKUN E ELBASANIT** **53****9****9. Struktura organike e sektorit të PMNZSH-së në Institucionin e Prefektit të qarkut Lezhë**

a) Shef sektori i PMNZSH-së së qarkut (niveli i lartë)	1
b) Shef zyre për parandalimin (niveli i mesëm)	1
c) Punonjës parandalimi (niveli bazë)	1
d) Ekonomiste (niveli i mesëm)	1
e) Portokollist-arkivist & magazinier (niveli bazë)	1
	<b>5</b>

**9.1 Stacioni i PMNZSH-së Lezhë**

a) Komandant stacioni dhe i stërvitjes (niveli i mesëm)	1
b) Punonjës informacioni (niveli bazë)	4
c) Përgjegjës-shërbimi (niveli bazë)	4
d) Personel zjarrfikës, shpëtues, luftues (niveli bazë)	8
e) Personel drejtimi automjetesh zjarrfikëse (niveli bazë)	8
	<b>25</b>

**9.2 Stacioni i PMNZSH-së Mirditë**

a) Komandant stacioni, inspektor parandalimi (niveli bazë)	1
b) Personel zjarrfikës, shpëtues, luftues (niveli bazë)	4
c) Personel drejtimi automjetesh zjarrfikëse (niveli bazë)	4
	<b>9</b>

**9.3 Stacioni i PMNZSH-së Laç**

a) Komandant stacioni, inspektor parandalimi (niveli bazë)	1
b) Personel zjarrfikës, shpëtues, luftues (niveli bazë)	4
c) Personel drejtimi automjetesh zjarrfikëse (niveli bazë)	4
	<b>9</b>

**GJITHSEJ PUNONJËS NË QARKUN E LEZHËS** **48****10****10. Struktura organike e sektorit të PMNZSH-së në Institucionin e Prefektit të qarkut Shkodër**

a) Shef sektori i PMNZSH-së së qarkut (niveli i lartë)	1
b) Shef zyre për parandalimin (niveli i mesëm)	1
c) Punonjës inspektim parandalimi (niveli i mesëm)	2
d) Ekonomiste (niveli i mesëm)	1
e) Portokollist-arkivist & magazinier (niveli bazë)	1
	<b>6</b>

**10.1 Stacioni i PMNZSH-së Shkodër**

a) Komandant stacioneve dhe stërvitjes (niveli i mesëm)	1
b) Punonjës informacioni (niveli bazë)	4
c) Përgjegjës shërbimi (niveli bazë)	4
d) Personel zjarrfikës, shpëtues, luftues (niveli bazë)	12
e) Personel drejtimi automjetesh zjarrfikëse (niveli bazë)	8
	<b>29</b>

**10.2 Stacioni i PMNZSH-së Malësia e Madhe**

a) Komandant stacioni, inspektor parandalimi (niveli bazë)	1
b) Personel zjarrfikës, shpëtues, luftues (niveli bazë)	4
c) Personel drejtimi automjetesh zjarrfikëse (niveli bazë)	4
	<b>9</b>



**10.3 Stacioni i PMNZSH-së Pukë**

a) Komandant stacioni, inspektor parandalimi (niveli i mesëm)	1
b) Përgjegjës-shërbimi (niveli bazë)	4
c) Personel zjarrfikës, shpëtues, luftues (niveli bazë)	4
d) Personel drejtimi automjetesh zjarrfikëse (niveli bazë)	4
	<b>13</b>

**GJITHSEJ PUNONJËS NË QARKUN E SHKODRËS 57****11****11. Struktura organike e sektorit të PMNZSH-së në Institucionin e Prefektit të qarkut Kukës**

a) Shef sektori i PMNZSH-së së qarkut (niveli i lartë)	1
b) Shef zyre për inspektim-parandalimin (niveli i mesëm)	1
c) Ekonomiste (niveli i mesëm)	1
d) Portokollist-arkivist dhe magazinier (niveli i mesëm)	1
	<b>4</b>

**11.1 Stacioni i PMNZSH-së Kukës**

a) Komandant stacioni (niveli i mesëm)	1
b) Punonjës informacioni (niveli bazë)	4
c) Përgjegjës shërbimi (niveli bazë)	4
d) Personel zjarrfikës, shpëtues, luftues (niveli bazë)	4
e) Personel drejtimi automjetesh zjarrfikëse (niveli bazë)	4
	<b>17</b>

**11.2 Stacioni i PMNZSH-së Tropojë**

a) Komandant stacioni, inspektor parandalimi (niveli bazë)	1
b) Personel zjarrfikës, shpëtues, luftues (niveli bazë)	4
c) Personel drejtimi automjetesh zjarrfikëse (niveli bazë)	4
	<b>9</b>

**11.3 Stacioni i PMNZSH-së “Tuneli Thirë-Kalimash”**

a) Komandant stacioni (niveli i mesëm)	1
b) Përgjegjës-shërbimi (niveli bazë)	4
c) Personel zjarrfikës, luftues (niveli bazë)	8
d) Personel drejtimi automjetesh zjarrfikëse (niveli bazë)	8
	<b>21</b>

**11.4 Stacioni i PMNZSH-së Has**

a) Komandant stacioni, inspektor profilaksie (niveli bazë)	1
b) Personel zjarrfikës, shpëtues, luftues (niveli bazë)	4
c) Personel drejtim automjetesh zjarrfikëse (niveli bazë)	4
	<b>9</b>

**GJITHSEJ PUNONJËS NË QARKUN E KUKËSIT 64****12****12. Struktura organike e sektorit të PMNZSH-së në Institucionin e Prefektit të qarkut Dibër**

a) Shef sektori i PMNZSH-së së qarkut (niveli i lartë)	1
b) Inspektor për parandalimin (niveli i mesëm)	1
c) Ekonomiste (niveli i mesëm)	1
d) Portokollist-arkivist & magazinier (niveli bazë)	1
	<b>4</b>

**12.1 Stacioni i PMNZSH-së Peshkopi**

a) Komandant stacioni (niveli i mesëm)	1
b) Punonjës informacioni (niveli bazë)	4
c) Përgjegjës-shërbimi (niveli bazë)	4
d) Personel zjarrfikës, shpëtues, luftues (niveli bazë)	4
e) Personel drejtimi automjetesh zjarrfikëse (niveli bazë)	4
	<b>17</b>

### 12.2 Stacioni i PMNZSH-së Bulqizë

a) Komandant stacioni, inspektor profilaksie (niveli bazë)	1
b) Personel zjarrfikës, shpëtues, luftues (niveli bazë)	4
c) Personel drejtimi automjeteve zjarrfikëse (niveli bazë)	4
	<b>9</b>

### 12.4 Stacioni i PMNZSH-së Burrel

a) Komandant stacioni, inspektor profilaksie (niveli bazë)	1
b) Personel zjarrfikës, shpëtues, luftues (niveli bazë)	4
c) Personel drejtimi automjeteve zjarrfikëse (niveli bazë)	4
	<b>9</b>

### GJITHSEJ PUNONJËS NË QARKUN E DIBRËS

**35**

### TOTALI I LIMITIT ORGANIK I PMNZSH-SË

**739 PUNONJËS**

#### VENDIM

Nr. 238, datë 23.4.2014

#### PËR SHPALLJEN E LAGUNËS SË KARAVASTASË SI ZONË BASHKËMENAXHUESE E PESHKIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 54 të ligjit nr. 64/2012, datë 31.5.2012, "Për peshkimin", me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

#### VENDOSI:

1. Shpalljen e lagunës së Karavastasë si zonë bashkëmenaxhuese e peshkimit, duke pasur parasysh statusin mbrojtës të lagunës, si pjesë e Parkut Kombëtar Divjakë - Karavasta e zonë natyrore, veçanërisht e mbrojtur, dhe si habitate të shpendëve ujorë, të përfshirë në listën e Konventës Ramsar.

2. Veprimtaritë dhe investimet që do të kryhen në lagunën e Karavastasë të jenë në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 8906, datë 6.6.2002, "Për zonat e mbrojtura", të ndryshuar, dhe me objektivat e planit të menaxhimit të Parkut Kombëtar Divjakë - Karavasta.

3. Plani i bashkëmenaxhimit për lagunën e Karavastasë miratohet me urdhër të ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, brenda 12 muajve nga data e miratimit të kësaj zone.

4. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministria e Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**

#### VENDIM

Nr. 245, datë 30.4.2014

#### PËR PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE DHE TË PROCEDURAVE PËR PËRMIRËSIMIN E PËRDITËSIMIN E TË DHËNAVE TË REGJISTRIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5 të nenit 64 të ligjit nr. 33/2012, "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

#### VENDOSI:

1. Përcaktimin e kushteve dhe procedurave për kryerjen e përmirësimit dhe përditësimit të të dhënave të regjistrit të pasurive të paluajtshme që administrohet në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në formate digjitale dhe manuale.

2. Përmirësimi dhe përditësimi i të dhënave të regjistrit të pasurive të paluajtshme është proces që ka për qëllim:

a) aktualizimin dhe garantimin e informacionit për pasuritë e paluajtshme, të regjistruara;

b) saktësimin e të dhënave të regjistrimit fillestar;

c) përditësimin e të dhënave të regjistrimit fillestar, në bazë të transaksioneve të kryera nga ZVRPP-ja, pas procesit të regjistrimit fillestar;

ç) regjistrimin e pasurive të paluajtshme që ndodhen brenda kufirit të zonës kadastrale, të paregjistruara më parë;

d) rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj klientit.

3. Përmirësimi dhe përditësimi i të dhënave të regjistrit të pasurive të paluajtshme është një proces që lidhet me:

a) indeksimin dhe sistemimin e arkivit digjital të dokumentacionit tekniko-ligjor;

b) saktësimin e pozicionit gjeografik e të kufijve të pasurive të paluajtshme si dhe të elementeve matematike të hartës kadastrale;

c) saktësimin e të dhënave në kartelën digjitale të pasurisë së paluajtshme.

4. Përmirësimi dhe përditësimi i të dhënave të regjistrit të pasurive të paluajtshme, kryhet në rastet kur:

a) të dhënat e pasqyruara në to nuk përputhen me ato të aktit të fitimit të pronësisë apo të së drejtës reale, të përdorur për kryerjen e regjistrimit;

b) nuk ekziston lidhja mes një karte dhe një harte kadastrale;

c) pozicioni gjeografik i pasurive, i pasqyruar në hartën kadastrale, nuk përkon me pozicionin gjeografik faktik të këtyre pasurive, sipas aktit të fitimit të pronësisë;

ç) pozicioni i kufirit të zonës kadastrale, i pasqyruar në hartën kadastrale, nuk përkon me pozicionin gjeografik faktik;

d) pasuri të paluajtshme, të ndodhura brenda kufirit të zonës kadastrale, nuk janë të regjistruara;

dh) elementet matematike të hartës kadastrale nuk janë të sakta;

e) indeksimi i dokumentacionit tekniko-ligjor nuk është në përputhje me standardet digjitale të miratuara.

5. Përmirësimi dhe përditësimi i të dhënave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme është një proces që përfshin të gjitha pasuritë e paluajtshme në territorin brenda kufirit të një zone kadastrale dhe do të quhet përmirësim sistematik.

6. Përmirësimi dhe përditësimi i të dhënave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme mund të kryhet edhe për pasuri apo grup pasurish të paluajtshme, të cilat kërkojnë përmirësime për raste të tjera të ngjashme, por që nuk renditen në mënyrë specifike në nenet 30, 31 dhe 63, të ligjit nr.33/2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, gjithmonë në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe do të quhet përmirësim sporadik.

7. Përmirësimi dhe përditësimi i të dhënave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme do të kryhet me kërkesë të subjektit të interesuar ose me nismën e regjistruesit dhe/ose të kryeregjistruesit.

8. Procesi i përmirësimit dhe përditësimit të të dhënave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme do të kryhet nga ZRPP-ja ose nga çdo person apo grup i autorizuar, me urdhër nga kryeregjistruesi, pas propozimit të regjistruesit. Urdhri i kryeregjistruesit publikohet dhe njoftohet sipas rregullave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

9. Kur kërkesa për përmirësimin sistematik të të dhënave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme bëhet me nismën e regjistruesit dhe të kryeregjistruesit, procesi do të kryhet sipas pikës 8 të këtij vendimi, bazuar në produktet digjitale dhe manuale të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, të administruara në ZVRPP deri në momentin e fillimit të këtij procesi, dhe në produktet fotogrametrike e programin ALBSReP.

10. I ngarkuari për kryerjen e procesit të përmirësimit, sipas pikës 8 të këtij vendimi, paralelisht me kryerjen e këtij procesi bën dhe verifikime në terren për pasurinë e paluajtshme, pjesë e procesit të përmirësimit. Të gjitha fondet që do të nevojiten për këtë proces, do të sigurohen nga ZRPP-ja, në bazë të buxhetit të saj.

11. Kur kërkesa për përmirësimin e të dhënave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme bëhet nga subjekte apo institucione të interesuara, me qëllim kryerjen e përmirësimit sistematik, procesi do të mbulohet financiarisht nga kërkuesi, duke aplikuar standardet e miratuara, në bazë të një marrëveshjeje me ZRPP-në, e cila monitoron e kontrollon procesin dhe konkluzionet përfundimtare.

12. Kur kërkesa për përmirësimin e të dhënave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme bëhet, sipas pikës 6 të këtij vendimi, nga subjekte të interesuara për kryerjen e përmirësimit sporadik, në ZVRPP, në të cilën ndodhet pasuria, objekt i kësaj kërkesë, kërkesa shoqërohet me dokumentacionin përkatës mbi të cilin bazohet. Aplikimi bëhet duke kryer pagesën e tarifës përkatëse për çdo pasuri që preket në procesin e përmirësimit sporadik.

13. Regjistruesi i ZVRPP-së përkatëse i propozon kryeregjistruesit fillimin e procesit për përmirësimin sporadik, duke i bashkëlidhur kërkesën e palës së interesuar dhe dokumentacionin shoqëruar të saj.

14. Kryeregjistruesi, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pas marrjes së propozimit, urdhëron ZVRPP-në për fillimin e procesit të përmirësimit sporadik, duke i vënë në dispozicion pjesë të produktit fotogrametrik ku ndodhet zona kadastrale përkatëse, si dhe modulet përkatëse të programit ALBSReP.

15. ZVRPP-ja, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes së urdhrit të kryeregjistruesit, kryen verifikimet përkatëse për produktin fotogrametrik dhe hartën kadastrale, duke përcaktuar numrin e pasurive që përfshihen në përmirësimin sporadik. Pavarësisht se kërkesa mund të jetë për përmirësimin e një pasurie të paluajtshme, procesi i përmirësimit sporadik do të përfshijë edhe pasuritë e tjera, të cilat preken nga përmirësimi i të dhënave të regjistrimit për pasurinë e paluajtshme që është objekt i kërkesës.

Në këtë numër pasurish do të përfshihen ato pasuri që ndodhen brenda parcelës bujqësore mëmë ose brenda një territori minimal me kufij natyrorë apo pasuri të paluajtshme, që dallohen qartë në produktet fotogrametrike dhe në terren.

16. Regjistruesi, bazuar në informacionin e nxjerrë pas verifikimeve të kryera, nxjerr urdhër për kryerjen e shënimit “Mbi pasurinë A/B po kryhet procesi i përmirësimit sporadik, sipas kërkesës së (emri i subjektit), me nr. \_\_, datë \_\_”, në seksionin “D” të kartelave të pasurive të paluajtshme, që preken nga përmirësimi, dhe njofton të gjithë pronarët përkatës për këtë shënim.

17. Pas verifikimit të kryer nga ZVRPP-ja, regjistruesi informon palën e interesuar për sa është verifikuar dhe i kërkon asaj të kryejë studimin hartografik të zonës ku do të kryhet procesi i përmirësimit sporadik, nëpërmjet inxhinierëve gjeodetë

të licencuar, duke i bashkëlidhur fragmente të hartës kadastrale ekzistuese dhe pjesë të produktit fotogrametrik.

18. Pala e interesuar, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas marrjes së shkresës nga regjistruesi i ZVRPP-së, duhet të paraqesë në ZVRPP studimin topografik në format manual dhe digjital.

19. Me paraqitjen e studimit topografik, ZVRPP-ja kryen procesin e përmirësimit të të dhënave digjitale dhe manuale të regjistrimit të pasurive të paluajtshme që janë përfshirë në procesin e përmirësimit sporadik. Procesi i përmirësimit sporadik të pasurive në formatin digjital do të kryhet në programin ALBSReP.

20. Nëse studimi nuk paraqitet brenda 30 (tridhjetë) ditëve, atëherë regjistruesi refuzon kryerjen e procesit të përmirësimit sporadik, nxjerr urdhrin për heqjen e shënimit të vendosur mbi pasuritë që do të ishin pjesë e përmirësimit sporadik, duke njoftuar kryeregjistruesin.

21. Kartela e pasurisë/pasurive të paluajtshme dhe harta kadastrale e përmirësuar, në zbatim të urdhrin të kryeregjistruesit, afishohen për një periudhë 45-ditore në mjediset e ZVRPP-së dhe të organit të qeverisjes vendore, ku ndodhet e pozicionuar zona apo pasuria, e cila i nënshtrohet përmirësimit dhe/ose përditësimit të të dhënave.

Brenda afatit të afishimit publik, personat e interesuar kanë të drejtë të paraqesin pretendimet për përmirësimin e të dhënave pas periudhës së afishimit publik. Të gjitha pasuritë e paluajtshme, për të cilat nuk ka asnjë pretendim, do të regjistrohen siç janë në kartelat dhe hartat kadastrale të përmirësuar.

22. Pretendimet e paraqitura gjatë afishimit publik shqyrtohen nga regjistruesi. Mosmarrëveshjet, që nuk zgjidhen ndërmjet palëve, zgjidhen nga organet gjyqësore dhe fakti i ekzistencës së kësaj mosmarrëveshjeje pasqyrohet në kartelën e pasurisë/ve të paluajtshme, objekt shqyrtimi.

23. Urdhri i kryeregjistruesit për fillimin e procesit të përmirësimit sistematik/sporadik publikohet në faqen zyrtare të internetit të Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, me qëllim informimin e publikut.

24. Ngarkohet Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**

**UDHËZIM**  
**Nr. 95, datë 7.4.2014**

**PËR PËRCAKTIMIN E INSTITUCIONEVE DHE  
ORGANEVE QË MARRIN TË DHËNA  
PERSONALE NGA SHËRBIMI I GJENDJES  
CIVILE, SI DHE MËNYRËN, LLOJIN DHE SASINË  
E INFORMACIONIT QË DUHET TË MARRIN**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikave 2, 2/1 dhe 3 të nenit 3, të pikës 2 të nenit 60 të ligjit nr. 10129, datë 11.5.2009, "Për gjendjen civile", të ndryshuar, si dhe shkronjës "k" të pikës 1 të nenit 31 dhe nenit 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", të ndryshuar,

**UDHËZOJMË:**

1. Institucionet/organet që mund të marrin të dhëna personale nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile, nga regjistrat themeltarë dhe nga aktet e gjendjes civile, janë ato, të cilave kjo e drejtë u njihet me ligj të veçantë. Mënyra, lloji dhe sasia e informacionit që duhet të marrin, është sipas aneksit I, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

2. Mënyra e marrjes së informacionit nga institucionet dhe organet, të cilat, sipas aneksit I, bashkëlidhur këtij udhëzimi, do të marrin informacion në formatin elektronik, do të përcaktohet me marrëveshje dypalëshe midis Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile dhe institucionit/organit përkatës.

3. Institucionet dhe organet, të cilat sipas aneksit I, bashkëlidhur këtij udhëzimi, do të marrin informacion në formë shkresore, do t'i drejtohen me kërkesë të motivuar Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, ose zyrës përkatëse të gjendjes civile, që administron dokumentacionin për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar.

4. Kërkesat drejtuar shërbimit të gjendjes civile, sipas pikës 3 të këtij udhëzimi, duhet të shoqërohen me formularin sipas aneksit III, bashkëlidhur këtij udhëzimi, në të cilin personi, subjekt i të dhënave, ka shprehur pëlqimin e tij.

5. Institucionet dhe organet që kërkojnë të dhëna personale në kërkesë duhet të shprehin qartë bazën ligjore, mbi të cilën mbështesin kërkesën e tyre, qëllimin për të cilin do të përdoren këto të dhëna, si dhe llojin e të dhënave që kërkojnë. Të dhënat personale jepen vetëm në rastet kur ato nevojiten për përmbushjen e një detyrimi të parashikuar ligjor dhe të përligjur.

6. Kërkesa për marrjen e të dhënave personale bëhet duke plotësuar formularin "Kërkesë për marrjen e të dhënave personale", sipas aneksit II, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

7. Institucionet dhe organet, që marrin të dhëna personale, në asnjë rast nuk duhet t'i përhapin ato tek

institucione apo organe të treta, pavarësisht faktit se këto të fundit mund të jenë të legjitimuara për t'i pasur këto të dhëna.

8. Punonjësit e zyrave të gjendjes civile regjistrojnë të gjitha kërkesat, duke evidentuar datën kur është paraqitur kërkesa, institucionin apo organin që kërkon të dhëna personale, të dhënat që kërkohen dhe ato të cilat janë dhënë ose jo, si dhe qëllimin për të cilin synojnë t'i përdorin këto të dhëna. Këto informacione i jepen, nëse i kërkon, Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, i cili mund t'i përdorë për qëllime hetimi administrativ ose për qëllime statistikore.

9. Nëse ka të dhëna se një institucion ose organ, i cili nuk përmendet në aneksin I, por që ka të drejtë të marrë të dhëna nga shërbimi i gjendjes civile, mbi bazën e një parashikimi ligjor, ose kjo e drejtë lind pas miratimit të

këtij udhëzimi, ministri i Punëve të Brendshme dhe Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale përditësojnë aneksin I. Përditësimi i listës kryhet në mënyrë periodike.

10. Ngarkohen me zbatimin e këtij udhëzimi Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, nëpunësit e zyrave të gjendjes civile në bashki/njësi bashkiake/komuna dhe në degët e qarkut, të gjitha institucionet, organet, personat juridikë/fizikë, publikë/privatë, të cilët, për përmbushjen e një detyrimi ligjor dhe të përligjur, kërkojnë të marrin të dhëna personale nga shërbimi i gjendjes civile.

Ky udhëzim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I PUNËVE TË BRENDSHME**  
**Saimir Tahiri**

**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN**  
**E TË DHËNAVE PERSONALE**  
**Flora Çabej Pogaçe**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN  
E TË DHËNAVE PERSONALE

## ANEKSI I

## LISTA E INSTITUCIONEVE QË MARRIN INFORMACION, BAZA LIGJORE PËRKATËSE, LLOJI DHE SASIA E INFORMACIONIT QË JEP SHËRBIMI I GJENDJES CIVILE DHE MËNYRA E VËNIES NË DISPOZICION TË KËTJË INFORMACIONI

Nr.	Subjektet (kontrolluesit) që marrin të dhëna	Baza ligjore	Të dhënat personale që duhet të jepen nga shërbimi i gjendjes civile në përputhje me legjislacionin përkatës dhe për mbrojtjen e të dhënave personale	Mënyra e vënies në dispozicion të informacionit të kërkuar
<b>1</b>	<b>MINISTRIA E DREJTËSISË</b>			
<b>1.1</b>	<b>Shërbimi i Provës</b>	Ligji nr. 8331, datë 21.4.1998, ndryshuar me ligjin nr. 10024, datë 27.11.2008 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, Neni 31/7 “Shërbimi i provës”	Të dhënat që përmban certifikata e vdekjes.	Në formë shkresore, sipas kërkesës.
<b>1.2</b>	<b>Zyra e Përbarimit</b>	1. Ligji nr. 8730, datë 18.1.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përbarimit Gjyqësor” Neni 26 “Mbledhja dhe administrimi i të dhënave” 2. Ligji nr. 10031, datë 11.12.2008 “Për shërbimin përbarimor gjyqësor privat” (i ndryshuar me ligjin nr. 36, datë 29.3.2012) Neni 31 “Të drejtat e përbaruesit gjyqësor privat”	Të gjitha të dhënat e domosdoshme për kryerjen e funksioneve të përcaktuara me ligj dhe të vlerësuar në përputhje me qëllimin e përcaktuar në kërkesë.  Vetëm adresa/vendndodhja e debitorit.	Në formë shkresore, sipas kërkesës.  Në formë shkresore, sipas kërkesës.
<b>1.3</b>	<b>Avokati i Shtetit</b>	Ligji, nr. 10018, datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit”. Neni 16 “Marrëdhëniet e Avokaturës së Shtetit me institucionet shtetërore”	Të gjitha të dhënat e domosdoshme për kryerjen e funksioneve të përcaktuara me ligj dhe vlerësuar në përputhje me qëllimin e përcaktuar në kërkesë.	Në formë shkresore, sipas kërkesës.
<b>1.4</b>	<b>Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve</b>	1. Ligji nr. 8328, datë 16.4.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të parburgosurve”, i ndryshuar. 2. VKM nr. 303, datë 25.3.2009 “Për miratimin e rregullores së përgjithshme të burgjeve”(ndryshuar me: a) VKM-në nr. 187, datë 17.3.2010 dhe b) VKM-në nr. 73, datë 2.2.2011) Neni 6 “Pranimi i të parburgosurve”; Neni 7 “Pranimi i të dënuarve”; Neni 10 “Dosja personale”; Neni 11 “Regjistrat themeltarë të të dënuarve dhe të parburgosurve”.	Të dhënat që ndodhen edhe në dokumentin e identifikimit të të dënuarit: - Emër; - Mbiemër; - Numri personal; - Atësi; - Amësi; - Datëlindje; - Vendlindje; - Vendbanimi (adresa); si dhe çdo informacion tjetër që kërkohet për të plotësuar qëllimin.	Në formë shkresore, sipas kërkesës.

1.5	<b>Prokuroria (për çështje penale)</b>	Kodi i Procedurës Penale Neni 2 “Respektimi i normave procedurale”	Të gjitha të dhënat e domosdoshme për kryerjen e funksioneve të përcaktuara me ligj, që lidhen me çështjen në shqyrtim dhe me qëllimin.	Elektronikisht, nëpërmjet ndërfaqes elektronike, të miratuar midis DPGJC-së dhe Prokurorisë, në zbatim të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore”.
1.6	<b>ZRPP</b>	Ligji nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” Neni 7 “Regjistri i pasurive të paluajtshme” Rregullore nr. 184, datë 8.4.1999 ”Për punën në ZRPP”	Të dhënat që përmban certifikata e lindjes dhe certifikata familjare.	Elektronikisht, nëpërmjet ndërfaqes elektronike, të miratuar midis DPGJC-së dhe ZRPP-së, në zbatim të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore”.
<b>2</b>				
<b>MINISTRIA E FINANCAVE</b>				
2.1	<b>Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe drejtoritë përkatëse rajonale</b>	Ligji nr. 8449, datë 27.1.1999, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, neni 295	Të dhënat si më poshtë: - Emër; - Mbiemër; - Numri personal; - Atësi; - Amësi; - Datëlindje; - Vendbanimi (adresa).	Në formë shkresore, sipas kërkesës elektronike, të miratuar midis DPGJC-së dhe Ministrisë së Financave, në zbatim të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore”.
2.2	<b>Autoritetet tatimore</b>	1. Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Neni 62 “Personat, të cilëve u adresohet kërkesa për të dhënë informacion” 2. Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar. Neni 13 “Detyrimi për të paguar” deri 13/10 3. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 899, datë 14.12.2011 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 55, datë 3.2.2010 të Këshillit të Ministrave, “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, pika 5.4 4. Udhëzimi nr. 5, datë 30.1.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, pika 2.8	Të dhënat si më poshtë: - Emër; - Mbiemër; - Numri personal; - Atësi; - Amësi; - Vendbanimi (adresa).	Elektronikisht, nëpërmjet ndërfaqes elektronike, të miratuar midis DPGJC-së dhe Ministrisë së Financave, në zbatim të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore”.

2.3	<b>Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave</b>	Ligji nr. 9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit”, i ndryshuar. Neni 21 “Organizimi i autoritetit përgjegjës”; Neni 22 “Detyrat dhe funksionet e autoritetit përgjegjës”.	Të dhënat si më poshtë: - Emër; - Mbiemër; - Numri personal; - Atësi; - Amësi; - Datëlindje; - Vendlindje; - Gjendja civile.	Në formë shkresore, sipas kërkesës.
2.4	<b>Agjencia e Trajtimit të Kredive</b>	Ligji nr. 8894, datë 14.5.2002 “Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive”, (i ndryshuar me ligjin nr. 9731, datë 10.5.2007) Neni 10	Të dhënat si më poshtë: - Emër; - Mbiemër; - Numër personal; - Atësi; - Amësi; - Datëlindje; - Vendbanimi (adresa).	Në formë shkresore, sipas kërkesës.
2.5	<b>Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF)</b>	1. Ligji nr. 9572, datë 3.7.2006, “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”. Neni 14 “Kompetencat e Bordit”, pika 14 Neni 15 “Kompetencat e kryetarit të Bordit”, pika 9 Neni 18 “Procedura e ekzekutimit të të drejtave të Bordit dhe të strukturave të Autoritetit”, pika 6, paragrafi 4. 2. Ligji nr. 10076, datë 12.2.2009, “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i ndryshuar. Neni 38 “Krijimi i qendrës së informacionit të sigurimeve dhe lloji i të dhënave që duhet të administrojë”, pika 4 Neni 41 “Shkëmbimi i informacionit dhe bashkëpunimi me autoritetet kompetente”, pika 4.	Të dhënat si më poshtë: - Emër; - Mbiemër; - Numri personal; - Datëlindje; - Gjinia; - Vendbanimi (adresa).	Elektronikisht, nëpërmjet ndërfaqes elektronike, të miratuar midis DPGJC-së dhe Ministrisë së Financave.
2.6	<b>Instituti i Sigurimeve Shoqërore (ISSH)</b>	1. Ligji nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar Neni 42 Pagesat për vdekje 1. Pagesa për vdekje i jepet: a) një personi të siguruar ose një pensionisti në rast vdekjeje të një anëtarit të familjes që ai e ka në ngarkim. b) personit që u kujdes për personin e siguruar të vdekur, i cili pagoi shpenzimet e varrimit. Udhëzimi nr. 3912, datë 21.6.2004 “Mbi procedurat për përballimin nga shteti të shpenzimeve të shërbimit të varrimit për shtetasit shqiptarë, që vdesin brenda dhe jashtë shtetit”.	Për të gjithë shtetasit shqiptarë, të cilët janë pjesë e skemës së sigurimeve shoqërore. Të dhënat që përmban certifikata e vdekjes, si më poshtë: - Emër; - Mbiemër para ose pas martese; - Numër personal; - Atësi; - Mëmësi - Data e lindjes; - Vendlindje; - Gjinia; - Gjendja civile;	Elektronikisht, nëpërmjet ndërfaqes elektronike, të miratuar midis DPGJC-së dhe ISSH-së, në zbatim të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore”.



		Neni 3 “Ndihma në lekë tërhiqet nga të interesuarit pranë zyrës së financës në bashkinë apo komunën përkatëse kundrejt paraqitjes së certifikatës së vdekjes së të ndjerit me shënimin “Shpenzime varrimi”. Për çdo rast pagese, financa e bashkisë apo e komunës, sipas certifikatës së paraqitur, llogarit masën e ndihmës, si dhe plotëson mandatpagesën.”	- Shtetësia; - Data e vdekjes; - Vendi i vdekjes; - Vendbanimi (adresa).	
3	<b>Avokati i Popullit</b>	Ligji nr. 8454, datë 4.2.1999 “Për Avokatin e Popullit”. Neni 19 “Procedura e hetimit” Neni 20 “E drejta për të kërkuar informacione apo dokumente sekrete shtetërore”	Të gjitha të dhënat e domosdoshme për kryerjen e funksioneve të përcaktuara me ligj, por që kanë lidhje me hetimin.	Në formë shkresore, sipas kërkesës.
4	<b>Komisioni Qendror i Zgjedhjeve</b>	Ligji nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar. Neni 27 “Zonat e administrimit zgjedhor” Neni 46 “Regjistrimi i zgjedhësve në listat e zgjedhësve” Neni 4 “Përmbajtja dhe formati i listës së zgjedhësve” Neni 56 “Përgatitja dhe shpallja e listës së zgjedhësve”	Të dhënat si më poshtë: - Emër; - Mbiemër; - Numër personal; - Atësi; - Amësi; - Datëlindje; - Vendbanimi (adresa).	Sipas kërkesave në formë shkresore jepet lista e zgjedhësve, elektronikisht, nëpërmjet ndërfaqes elektronike, të miratuar midis DPGJC-së dhe KQZ-së, në zbatim të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore”.
5	<b>Organet e qeverisjes vendore bashki/komuna</b>	Ligj nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar. Neni 49 “Organi që harton dhe miraton listat”	Të gjitha të dhënat e domosdoshme për kryerjen e funksioneve të përcaktuara me ligj dhe vlerësuar në përputhje me qëllimin e përcaktuar në kërkesë.	Elektronikisht, nëpërmjet ndërfaqes elektronike, të miratuar midis DPGJC-së dhe KQZ-së, në zbatim të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore”.
6	<b>Përfaqësuesit dhe avokatët me prokurë</b>	1. Ligji nr. 10129, datë 11.5.2009 “Për gjendjen civile”, i ndryshuar Neni 3 “Karakteret personal i të dhënave” 2. Ligji nr. 9109, datë 17.7.2003 “Për profesionin e avokatit në RSH”, i ndryshuar, neni 6	Të dhënat që kanë lidhje me personin që përfaqëson avokati dhe që kanë lidhje me çështjen, ose personin që përfaqësohet ose mbrohet prej tij.	Në formë shkresore, sipas kërkesës.
7	<b>Ministria e Mbrojtjes, institucionet në varësi të saj dhe repartet ushtarake</b>	1. Ligji nr. 9074, datë 29.5.2003 “Për shërbimin informativ ushtarak”. Neni 5 “Detyrat” Neni 10 “Bashkëpunimi me institucionet shtetërore e private” 2. Ligji nr. 9069, datë 15.5.2003 “Për Policinë Ushtarake dhe Forcat e Armatosura në Republikën e Shqipërisë”, neni 4	Të dhënat si më poshtë: - Emër; - Mbiemër; - Numër personal; - Atësi; - Amësi; - Datëlindje; - Vendbanimi (adresa).Këto të dhëna u përkasin personave për të cilët ka filluar procedimi penal për vepra të parashikuara nga Kodi Penal dhe Kodi Penal Ushtarak.	Në formë shkresore, sipas kërkesës.

8				
<b>Ministria e Punëve Publike dhe Transportit</b>				
8.1	<b>Enti Kombëtar i Banesave, Drejtoria e Përgjithshme</b>	1. Ligji nr. 7652, datë 23.12.1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore”. Neni 4 dhe neni 20 2. Udhëzimi nr. 22, datë 12.10.2010 “Procedurat e shitjes së objekteve të miratuara për privatizim sipas vendimeve të Këshillit të Ministrave .....”, pika 2 dhe pika 3	Të dhënat që përmban certifikata familjare, si më poshtë: - Emër; - Mbiemër; - Numër personal; - Atësi; - Amësi; - Datëlindje; - Gjendja civile; - Vendlindje; - Shtetësi.	Në formë shkresore, sipas kërkesës.
8.2	<b>DPSHTRR</b>	Kodi Rrugor, miratuar me ligjin nr. 8378, datë 22.7.1998, të ndryshuar. Udhëzimi nr. 1, datë 18.1.2012 “Për dokumentet e qarkullimit dhe të regjistrimit të mjeteve rrugore me motor dhe të rimorkiove të tyre”, i ndryshuar.	Të dhënat personale që përmban letërnjoftimi (karta e identitetit).	Elektronikisht, nëpërmjet ndërfaqes elektronike, të miratuar midis DPGJC-së dhe MPPT-së, në zbatim të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore”.
8.3	<b>Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale (ALUIZNI)</b>	Pika c, neni 27, e ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”. Neni 27 “Dokumentacioni tekniko-ligjor për legalizimin e objektit”	Të dhënat që përmban certifikata familjare.	Në formë shkresore, sipas kërkesës.
<b>9</b>				
<b>Ministria e Shëndetësisë</b>				
9.1	<b>ISKSH</b>	Ligji nr. 10383, datë 24.2.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë” (i cili hyn në fuqi 2 vjet pas botimit në Fletoren Zyrtare nr. 25, datë 25.3.2011). Neni 5 “Personat e siguruar” Neni 27 “Regjistrimi dhe identifikimi i personave të siguruar”, paragrafët 5 dhe 6.	Të dhënat që përmban certifikata personale, certifikata familjare dhe certifikata e lëshuar nga akti i vdekjes.	Elektronikisht, nëpërmjet ndërfaqes elektronike, të miratuar midis DPGJC-së dhe MSH-së, në zbatim të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore”.
<b>10</b>				
<b>Ministria e Punëve të Brendshme</b>				
10.1	<b>Policia e Shtetit</b>	Ligji nr. 9749, datë 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit” Neni 114 “Mbledhja e të dhënave”	Të gjitha të dhënat e domosdoshme për kryerjen e funksioneve të përcaktuara me ligj dhe vlerësuar në përputhje me qëllimin.	Elektronikisht, nëpërmjet aksesit online në RKGJC.
11	<b>Ministria e Punëve të Jashtme</b>	Ligji nr. 8372, datë 9.7.1998 “Për ushtrimin e funksioneve konsullore nga përfaqësitë diplomatike ose konsullore”.	Të gjitha të dhënat e domosdoshme për kryerjen e funksioneve të përcaktuara me ligj dhe vlerësuar në përputhje me qëllimin.	Elektronikisht, nëpërmjet aksesit online në RKGJC, në zbatim të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore”.

12	<b>Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë</b>	1. Ligji nr. 9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, neni 27, pika 1. 2. Ligji nr. 7995 datë 20.9.1995 “Për nxitjen e punësimit”, i ndryshuar, Neni 25 “Ministria dhe institucionet”, pika 3.	Të dhënat që përmban certifikata familjare.	Elektronikisht, nëpërmjet aksesit online në RKGJC, në zbatim të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore”.
13	<b>Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit</b>	Ligji nr. 9734, datë 14.5.2007 “Për turizmin” Neni 15 “Njësitë e qeverisjes vendore dhe detyrat e tyre për turizmin” Neni 17 “Regjistri kombëtar i burimeve turistike”	Të dhënat e domosdoshme për kryerjen e funksioneve të përcaktuara me ligj/vlerësuar në përputhje me qëllimin e përcaktuar në kërkesë.	Në formë shkresore, sipas kërkesës.
14	<b>Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave</b>	1. Ligji nr. 9817, datë 22.10.2007 “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural” Neni 23 “Marrja dhe përdorimi i bazave të tjera të të dhënave” 2. Ligji nr. 10263, datë 8.4.2010 “Për përdorimin dhe shfrytëzimin e tokave bujqësore të pakultivuara”	Të dhënat e domosdoshme për kryerjen e funksioneve të përcaktuara me ligj/vlerësuar në përputhje me qëllimin e përcaktuar në kërkesë.	Në formë shkresore, sipas kërkesës.
15	<b>Ministria e Kulturës</b>	1. Ligj nr. 8576, datë 3. 2. 2000 “Për bibliotekat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Neni 28 “Bibliotekat publike”, pika 7.	Të dhënat e domosdoshme për kryerjen e funksioneve të përcaktuara me ligj/vlerësuar në përputhje me qëllimin e përcaktuar në kërkesë.	Në formë shkresore, sipas kërkesës.
16	<b>Instituti i Statistikave</b>	Ligji nr. 9180, datë 5.2.2004 “Për statistikat zyrtare” Neni 8 “Detyrat dhe të drejtat e INSTAT-it” Neni 13 “Detyrat dhe misioni i agjencive të tjera”	Të gjitha të dhënat personale që përmban RKGJC-ja.	Elektronikisht, nëpërmjet aksesit online në RKGJC, në zbatim të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore”.
17	<b>ILDKP</b>	Ligj nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” Neni 9 “Burime të tjera informacioni për interesat private të zyrtarit”	Të gjitha të dhënat e domosdoshme për kryerjen e funksioneve të përcaktuara me ligj/vlerësuar në përputhje me qëllimin e përcaktuar në kërkesë.	Në formë shkresore, sipas kërkesës.
18	<b>Shërbimi Informativ i Shtetit</b>	Ligji nr. 8391, datë 28.10.1998 “Për Shërbimin Informativ Kombëtar”, i ndryshuar, neni 3	Të gjitha të dhënat e domosdoshme për kryerjen e funksioneve të përcaktuara me ligj/vlerësuar në përputhje me qëllimin.	Elektronikisht, nëpërmjet aksesit online në RKGJC, në zbatim të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore”.
19	<b>Përfaqësitë diplomatike të qeverive të huaja</b>	Ligji nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar, konkretisht nenet 8 dhe 9. Vendimi nr. 3, datë 20.11.2012 “Për përcaktimin e shteteve me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale” i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.	Të dhënat e domosdoshme, të cilat vlerësohen të nevojshme për plotësimin e qëllimit. Marrësi në kërkesë përcakton qartë qëllimin e marrjes së të dhënave. Transferuesi i të dhënave vlerëson dhënien e sasisë së të dhënave në përputhje me qëllimin.	Në formë shkresore, sipas kërkesës.

ANEKS II

Protokolluar me nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_

**FORMULAR - KËRKESË  
PËR MARRJEN E TË DHËNAVE PERSONALE NGA REGJISTRAT E GJENDJES CIVILE**

Kërkuesi: Emri i institucionit/organit \_\_\_\_\_  
Emri i titullarit të institucionit/organit \_\_\_\_\_  
Adresa \_\_\_\_\_  
Telefon \_\_\_\_\_

Drejtuar: Zyrës së Gjendjes Civile \_\_\_\_\_  
Adresa: \_\_\_\_\_

Tiranë

Përmbajtja e kërkesës:

a) Lloji i të dhënave me karakter personal që kërkohet të merret nga regjistrat e gjendjes civile

b) Baza ligjore mbi të cilën bazohet kërkesa (referencë të përmbledhësja e institucioneve dhe organeve që marrin të dhëna me karakter personal nga regjistrat e gjendjes civile)

c) Qëllimi për të cilin do të përdoren të dhënat me karakter personal të kërkuara

Emër, mbiemër dhe nënshkrimi i titullarit  
dhe vula e institucionit/organit

Datë \_\_\_\_\_

ANEKSI III

**DHËNIA E PËLQIMIT TË SUBJEKTIT PËR KONTROLL NË TË DHËNAT PERSONALE NË  
DOKUMENTACIONIN QË MBAN SHËRBIMI I GJENDJES CIVILE**

Unë \_\_\_\_\_, pas marrjes së informacionit të detajuar në lidhje me natyrën dhe rëndësinë e përpunimit të të dhënave personale nga kontrolluesi \_\_\_\_\_, si dhe pas marrjes së informacionit të detajuar mbi të drejtat e mia të parashikuara në ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar, jap pëlqimin tim të lirë për \_\_\_\_\_.

(Subjekti i autorizuar) të ketë të drejtën të kontrollojë të dhënat e mia personale në lidhje me emrin, mbiemrin, datën e lindjes dhe (të dhëna të tjera sipas rastit) \_\_\_\_\_, në dokumentacionin që mban shërbimi i gjendjes civile, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Qëllimi i këtij përpunimi do të jetë ekskluzivisht verifikimi i \_\_\_\_\_.

(Subjekti i autorizuar) \_\_\_\_\_, si kontrollues mund të përhapë ose të vërë në dispozicion të dhënat e mia personale të këta marrës: \_\_\_\_\_, me kusht që kjo përhapje të jetë absolutisht e nevojshme për përmbushjen e shërbimit të kërkuar ose nëse kontrolluesi kryen një përpunim që është thelbësor për përmbushjen e një detyrimi ligjor.

Kontrolluesi ka të drejtë të mbajë të dhënat e mia personale vetëm për një periudhë kohe prej \_\_\_\_ muajsh.

Kontrolluesi është i detyruar të shkatërrojë ose të bëjë anonime të dhënat e mia personale pas përfundimit të kësaj periudhe, përveç kur parashikohet ndryshe në bazë të një dispozite ose të një akti tjetër të veçantë.

Datë \_\_\_\_ / \_\_\_\_ / \_\_\_\_\_

Nënshkrimi \_\_\_\_\_

**VENDIM****Nr. 15, datë 13.3.2014****PËR MIRATIMIN E RAPORTIT VJETOR TË ERE-s  
“GJENDJA E SEKTORIT TË ENERGIJISË DHE  
VEPRIMTARIA E ERE-s GJATË VITIT 2013”**

Në zbatim të neneve 9 dhe 10, pika 1 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe ligjit nr. 9946, datë 30.6.2008 “Për sektorin e gazit natyror”, neni 13, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 13.3.2014, pasi shqyrtoi raportin vjetor të ERE-s, “Gjendja e sektorit të energjisë dhe veprimtaria e ERE-s gjatë vitit 2013”, të paraqitur nga kryetari i ERE-s,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e raportit vjetor të ERE-s “Gjendja e sektorit të energjisë dhe veprimtaria e ERE-s gjatë vitit 2013”, që do t'i paraqitet Kuvendit të Shqipërisë (raporti bashkëlidhur këtij vendimi).
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit Ahmeti**

**VENDIM****Nr. 16, datë 13.3.2014****MBI MIRATIMIN E UDHËZUESIT PËR  
MENAXHIMIN DHE ALOKIMIN E  
KAPACITETEVE NË PROJEKTIN TRANS  
ADRIATIC PIPELINE (TAP) PËR FAZËN E PARË  
TË REZERVIMIT (FIRST BOOKING PHASE)  
SIPAS “OPINIONIT TË PËRBASHKËT  
PËRFUNDIMTAR /FINAL JOINT OPINION” NË  
KUADËR TË PROCEDURËS SË PËRJASHTIMIT  
PËR GAZSJELLËSIN TAP**

Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 13.3.2014,  
Në zbatim të:

- Direktivës 2009/73/EC të Parlamentit Europian dhe të Këshillit të datës 13 korrik 2009 (në tekstin në vijim: direktiva 73/09);
- Rregullores 713/2009/EC të Parlamentit Europian dhe të Këshillit të datës 13 korrik 2009
- Rregullores 715/2009/EC të Parlamentit Europian dhe të Këshillit të datës 13 korrik 2009.
- Ligjit nr. 9946, datë 30.6.2008 “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar;
- Vendimit nr. 39, datë 23.4.2012 “Për miratimin e udhëzuesit për menaxhimin dhe alokimin e kapaciteteve në projektin Trans Adriatic Pipeline (TAP) sipas paragrafit 6 të nenit 36 të direktivës 2009/73/EC”;

- Vendimit nr. 27, datë 1.3.2013 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Për miratimin e përjashtimit të kushtëzuar të kompanisë TAP AG prej kërkesave të neneve 9, 32 dhe 41 (6), (8) dhe (10) të direktivës 2009/73/EC për projektin Trans Adriatic Pipeline”;

- Vendimit të Komisionit Europian C (2013) 2949 të datës 16 maj 2013, “*Exemption of Trans Adriatic Pipeline from the requirements on third party access, tariff regulation and ownership unbundling laid down in Articles 9, 32, 41(6), 41(8) and 41(10) of Directive 2009/73/EC*”;

- Opinionit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë (nr. 1/2013) të datës 14 maj 2013;

- Vendimit nr. 64, datë 13.6.2013 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Për amendimin e vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 27, datë 1.3.2013 “Për miratimin e përjashtimit të kushtëzuar të kompanisë TAP AG prej kërkesave të neneve 9, 32 dhe 41(6), (8) dhe (10) të direktivës 2009/73/EC për projektin Trans Adriatic Pipeline”, për marrjen në konsideratë të Opinionit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë (nr. 1/2013) dhe vendimit të Komisionit Europian (C(2013)2949” nëpërmjet miratimit të dokumentit “Opinion i Përbashkët Përfundimtar i Rregullatorëve të Energjisë mbi Aplikimin e TAP AG për Përjashtim. Autoriteti për Energjinë Elektrike dhe Gazin (Itali), Enti Rregullator i Energjisë (Shqipëri) dhe Autoriteti Rregullator i Greqisë (Greqi)”/ “*Final Joint Opinion of the Energy Regulators on TAP AG's Exemption Application Autorita per l'Energia Elettrica e il Gas (Italy), Enti Rregullator i Energjise (Albania) and Regulatory Authority of Greece (Greece)*” në vijim *Final Joint Opinion*;

- Vendimit nr. 127, datë 7.11.2013 “Mbi miratimin e metodologjisë së tarifave (TAP Tariff Code), të propozuar nga TAP AG, sipas detyrimeve të përcaktuara në “Opinionin e Përbashkët Përfundimtar /*Final Joint Opinion*” në kuadër të procedurës për përjashtimin e gazsjellësit TAP;

- Vendimit nr. 12, datë 14.2.2014 mbi shqyrtimin dhe miratimin e “Programit të Përputhshmërisë Rregullatore/*Regulatory Compliance Programme*” paraqitur nga TAP AG në bazë të “Opinionit të përbashkët përfundimtar /*Final Joint Opinion*” në kuadër të procedurës së përjashtimit për gazsjellësin TAP.

Duke konsideruar që:

- Shoqëria TAP AG ka paraqitur në ERE, në përputhje me ligjin nr. 9946, datë 30.6.2008 “Për sektorin e gazit natyror”, kërkesën për përjashtim në lidhje me projektin e një interkonjeksi që kalon nga Greqia dhe Shqipëria për të vijuar në Itali (në vijim gazsjellësi TAP) dhe, si të tillë, për efekt të përjashtimit, është e nevojshme përfshirja edhe e autoriteteve rregullatore (në vijim autoritetet) për Greqinë Enti Rregullator i Energjisë (në vijim RAE) dhe për Italinë Autoriteti për Energjinë Gazin dhe Ujërat (në vijim AEEGSI);

- Neni 36, paragrafi 6 të direktivës 73/09 parashikon që autoriteti rregullator para se të lejojë një përjashtim duhet të miratojë rregulla dhe mekanizma:

i) Për alokimin e kapacitetit, të cilat kërkojnë që të ftohen të gjithë përdoruesit e mundshëm të infrastrukturës për të shprehur interesin e tyre për përdorimin e kapacitetit përpara se të jetë kryer alokimi i këtij kapaciteti në infrastrukturën e re, përfshirë edhe për vetëpërdorim (këtu e në vazhdim: testimi i tregut).

ii) Për menaxhimin e kapaciteteve, të cilat përfshijnë të drejtën e zotëruesit për të shitur kapacitetet e papërdorura në tregun dytësor dhe detyrimin për të ofruar kapacitetin e papërdorur në treg në rast të “kufizimit kontraktual”;

- Dispozita e mësipërme gjithashtu kërkon që në vlerësimin e kritereve për dhënien e përjashtimit të kërkuar, autoritetet rregullatore duhet të marrin parasysh rezultatet e procedurës së alokimit të kapaciteteve;

- Në përputhje me dispozitat e sipërpërmendura, është zhvilluar pra një fazë e parë jodetyruese e testimit të tregut (Faza e shprehjes së interesit/*Expression of Interest Phase*), në të cilën të gjithë përdoruesit e mundshëm të gazsjellësit TAP ishin të ftuar për të shprehur interesin e tyre për përdorimin e kapacitetit të kësaj infrastrukture, si në lidhje me kapacitetin e ofruar nga TAP, ashtu edhe me propozimet për lloje të ndryshme të produkteve të ofruara.

- Në përfundim të fazës së parë të testimit të tregut (Faza e shprehjes së interesit/*Expression of Interest Phase*), pasi ERE i cilësoi të plotësuara kushtet e nenit 36 pika 6 të direktivës 73/09, me vendimin nr. 64, datë 13.6.2013 të Opinionit të Përbashkët Përfundimtar/*Final Joint Opinion*, ka shprehur mendim pozitiv për çështjen e vendimit formal për përjashtimin në favor të kompanisë TAP AG;

- “Opinionit i Përbashkët Përfundimtar/*Final Joint Opinion*” i sipërcituar parashikon edhe një fazë të dytë të testimit të tregut, në të cilin pjesëmarrësit e fazës së parë janë të ftuar të dorëzojnë kërkesat për rezervimin e kapacitetit të tubacionit (TAP “*Booking Phase*”);

- Në zbatim të ekzekutimit të fazës së parë të rezervimit/*First Booking Phase*, të planifikuar për 17 mars 2014, ERE ka përgatitur së bashku me RAE dhe AEEGSI “Udhëzuesin për Menaxhimin dhe Alokimin e Kapaciteteve të projektit Trans Adriatic Pipeline (TAP), në përputhje me paragrafin 6 të nenit 36 të direktivës 2009/73/EC-faza e dytë: ftesa për palët e interesuara të dorëzojnë kërkesa rezervimi detyruese për produktet e kapacitetit/*Guidelines for management and allocation of capacity of the Trans Adriatic Pipeline (TAP) project according to paragraph 6 of Article 36 of the Directive 2009/73/EC –Phase II: invitation to interested Parties to submit binding booking request for capacity products*” (këtu e në vazhdim: udhëzuesi), që nga ana e tij ka për qëllim të përcaktojë parimet e përgjithshme të cilave TAP AG duhet t’i përmbahet për hartimin e procedurës për pjesëmarrje në fazën e rezervimit/*Booking Phase* dhe për

menaxhimin dhe alokimin e kapaciteteve të gazsjellësit që janë disponibël;

- Në veçanti, udhëzuesi cituar më lart (*the Guidelines*) përcakton parimet e mëposhtme:

1. Në alokimin e kapaciteteve të gazsjellësit, produktet e ofruara duhet të pasqyrojnë ato për të cilat pjesëmarrësit e “Fazës së shprehjes së interesit/*Expression of Interest Phase*” kanë shprehur interesin e tyre dhe në veçanti, kapacitetet e vazhdueshme duhet të alokohen për kontrata afatgjata të trajtës *ship-or-pay* përkatësisht për një kohëzgjatje prej 5, 10, 15, 20 dhe 25 vjet dhe kapacitetet komerciale me fluks në drejtim të kundërt (*Commercial Reverse Flow*) me kontrata të trajtës *ship-or-pay* për një kohëzgjatje të njëjtë;

2. Pjesëmarrja në fazën e dytë të testimit të tregut (*Market Test*) është e rezervuar për individët të cilët morën pjesë në fazën e parë, si dhe për operatorët e rrjetit të cilët janë të certifikuar në përputhje me detyrimet përkatëse të çdo shteti sipas direktivës 73/09;

3. TAP AG ka detyrimin për të hartuar në njoftimin për fazën e rezervimit (*Booking Phase Notice*) procedurat për pjesëmarrjen në fazën e rezervimit/*Booking Phase*, për menaxhimin dhe alokimin e kapaciteteve disponibël të gazsjellësit, dhe gjithashtu është përgjegjës për zbatimin e drejtë të procedurave të përfshira në të;

4. TAP AG u siguron fituesve të suksesshëm të kapaciteteve të rezervuara, disponueshmërinë e tyre brenda 6 muajve nga koha kur kapaciteti i përjashtuar është vënë në dispozicion dhe në rast të dështimit për të përmbushur këtë afat, siguron kompensim për përdoruesit;

5. Kapaciteti i alokuar duhet të jetë në përputhje me vlerat maksimale (*capacity caps*) të përcaktuara në paragrafin 4.7 të Opinionit të Përbashkët Përfundimtar;

- Udhëzuesi (*the Guidelines*) i është nënshtruar vlerësimit të personave të cilët kanë të drejtë të marrin pjesë në fazën e rezervimit (*Booking Phase*) (që do të thotë, pjesëmarrësit në fazën e parë të testimit të tregut dhe operatorët e rrjeteve të certifikuara) për të mbledhur komentet e tyre;

- Komentet e marra nga pjesëmarrësit nëpërmjet fazave të sipërpërmendura, në përgjithësi kanë evidentuar nevojën për të marrë sqarime të mëtejshme në lidhje me disa aspekte të caktuara të udhëzuesit (*the Guidelines*),

- Si rezultat i procesit të lartpërmendur të njohjes, udhëzuesi (*the Guidelines*) është ndryshuar, së bashku me AEEGSI dhe RAE, duke marrë parasysh komentet e bëra nga rregullatorët.

- Në ndryshim nga sa ishte propozuar në udhëzuesin, i cili u dorëzua për konsultim (tek pjesëmarrësit potencialë), në lidhje me fazën e parë të rezervimit/*First Booking Phase*, autoritetet kanë vendosur që ofertat do të renditen bazuar në vlerën prezente neto për njësi kapaciteti pa përdorur ankand, dhe kjo zgjedhje siguron thjeshtësinë e procedurës dhe inkurajon përdorimin maksimal të

kapacitetit gjatë periudhës së përjashtimit, duke marrë në konsideratë detyrimin e TAP për të ndërtuar kapacitete shitesë në përputhje me paragrafin 4.1.5 të Opinionit të Përbashkët Përfundimtar/*Final Joint Opinion*.

Duke vlerësuar që:

- Janë përcaktuar së bashku me RAE dhe AEEGSI parimet e përgjithshme, të cilat TAP AG duhet të ndjekë për të zbatuar procedurën për pjesëmarrje në fazën e rezervimit (*Booking Phase*) dhe për menaxhimin dhe alokimin e kapaciteteve të gazsjellësit në disponim, në "Udhëzuesin për menaxhimin dhe alokimin e kapaciteteve të projektit Trans Adriatic Pipeline (TAP) në përputhje me paragrafin 6 të nenit 36 të direktivës 2009/73/EC- faza e dytë: Ftesa për palët e interesuara të paraqesin kërkesat për rezervim detyrues për produktet e kapaciteteve/*Guidelines for management and allocation of capacity of the Trans Adriatic Pipeline (TAP) project according to paragraph 6 of Article 36 of the Directive 2009/73/EC-Phase II: invitation to interested Parties to submit binding booking request for capacity products*", të cilat janë bashkëngjitur këtij vendimi,

#### VENDOSI:

1. Të miratojë "Udhëzuesin për menaxhimin dhe alokimin e kapaciteteve të projektit Trans Adriatic Pipeline (TAP) sipas paragrafit 6 të nenit 36 të direktivës 2009/73/EC - faza II: Ftesa për palët e interesuara të paraqesin kërkesat për rezervim detyrues për produktet e kapaciteteve/*Guidelines for management and allocation of capacity of the Trans Adriatic Pipeline (TAP) project according to paragraph 6 of Article 36 of the Directive 2009/73/EC-Phase II: invitation to interested Parties to submit binding booking request for capacity products*", bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Njoftimin e autoriteteve rregullatore të energjisë së Italisë (AEEGSI) dhe Greqisë (RAE) dhe TAP AG, për marrjen e këtij vendimi.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
Petrit Ahmeti

#### VENDIM Nr. 17, datë 13.3.2014

#### MBI SHQYRTIMIN DHE MIRATIMIN E "NJOFTIMIT TË FAZËS SË REZERVIMIT/BOOKING PHASE NOTICE" PARAQITUR NGA TAP AG PËR PROCEDURËN E ALOKIMIT TË KAPACITETEVE TË GAZSJELLËSIT TAP NË PËRPUTHJE ME UDHËZUESIN E APROVUAR ME VENDIMIN NR. 16, DATË 13.3.2014

Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 13.3.2014,

Në zbatim të:

- Direktivës 2009/73/EC të Parlamentit Europian dhe të Këshillit të datës 13 korrik 2009 (në tekstin në vijim: direktiva 73/09);

- Rregullores 713/2009/ EC të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, të datës 13 korrik 2009;

- Rregullores 715/2009/ EC të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, të datës 13 korrik 2009;

- Ligjit nr. 9946, datë 30.6.2008 "Për sektorin e gazit natyror", të ndryshuar;

- Vendimit nr. 39, datë 23.4.2012 "Për miratimin e udhëzuesit për menaxhimin dhe alokimin e kapaciteteve në projektin Trans Adriatic Pipeline (TAP) sipas paragrafit 6 të nenit 36 të direktivës 2009/73/EC";

- Vendimit nr. 79, datë 15.6.2012 "Për miratimin e dokumentit "Ftesë për shprehje interesi", të shpallur nga TAP AG në përputhje me udhëzuesin për menaxhimin dhe alokimin e kapaciteteve të projektit Trans Adriatic Pipeline (TAP) sipas paragrafit 6 të nenit 36 të direktivës 2009/73/EC;

- Vendimit nr. 27, datë 1.3.2013 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s "Për miratimin e përjashtimit të kushtëzuar të kompanisë TAP AG prej kërkesave të neneve 9, 32 dhe 41 (6), (8) dhe (10) të direktivës 2009/73/EC për projektin Trans Adriatic Pipeline";

- Vendimit të Komisionit Europian C (2013) 2949 të datës 16 maj 2013 "*Exemption of Trans Adriatic Pipeline from the requirements on third party access, tariff regulation and ownership unbundling laid down in Articles 9, 32, 41(6), 41(8) and 41(10) of Directive 2009/73/EC*";

- Opinionit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë (nr. 1/2013) të datës 14 maj 2013;

- Vendimit nr. 64, datë 13.6.2013 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s "Për amendimin e vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s" nr. 27 datë 1.3.2013 "Për miratimin e përjashtimit të kushtëzuar të kompanisë TAP AG prej kërkesave të neneve 9, 32 dhe 41(6), (8) dhe (10) të direktivës 2009/73/EC për projektin Trans Adriatic Pipeline", për marrjen në konsideratë të Opinionit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë (nr. 1/2013) dhe vendimit të Komisionit Europian (C(2013)2949" nëpërmjet miratimit të dokumentit "Opinion i Përbashkët Përfundimtar i Rregullatorëve të Energjisë mbi Aplikimin e TAP AG për Përjashtim. Autoriteti për Energjinë Elektrike, Gazin dhe Sistemet Ujore (Itali), Enti Rregullator i Energjisë (Shqipëri) dhe Autoriteti Rregullator i Greqisë (Greqi)" / "*Final Joint Opinion of the Energy Regulators on TAP AG's Exemption Application Autorita per l'Energia Elettrica e il Gas (Italy)*, Enti Rregullator i Energjisë (Albania) and *Regulatory Authority of Greece (Greece)*" në vijim *Final Joint Opinion*;

- Vendimit nr. 127, datë 7.11.2013 "Mbi miratimin e metodologjisë së tarifave" (*TAP Tariff Code*), të propozuar nga TAP AG, sipas detyrimeve të përcaktuara në

“Opinionin e Përbashkët Përfundimtar/*Final Joint Opinion*” në kuadër të procedurës për përjashtimin e gazsjellësit TAP;

- Vendimit nr. 12, datë 14.2.2014 “Mbi shqyrtimin dhe miratimin e “Programit të përputhshmërisë rregullatore/*Regulatory Compliance Programme*” paraqitur nga TAP AG në bazë të “Opinionit të Përbashkët Përfundimtar/*Final Joint Opinion*” në kuadër të procedurës së përjashtimit për gazsjellësin TAP.

- Vendimit nr. 16, datë 13.3.2014 “Mbi miratimin e “Udhëzuesit për menaxhimin dhe alokimin e kapaciteteve në projektin Trans Adriatic Pipeline (TAP) për fazën e parë të rezervimit (*First Booking Phase*) sipas Opinionit të Përbashkët Përfundimtar/*Final Joint Opinion*” në kuadër të procedurës së përjashtimit për gazsjellësin TAP”;

- Kërkesës së dorëzuar nga TAP AG nr. 272/1, datë 12.3.2014 për aprovimin e “Njoftimit të fazës së rezervimit/*Booking Phase Notice*”, i cili përmban rregullat dhe procedurat për pjesëmarrje në fazën e parë të rezervimit/*First Booking Phase*.

Duke konsideruar që:

- Shoqëria TAP AG ka paraqitur në ERE, në përputhje me ligjin nr. 9946, datë 30.6.2008 “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, kërkesën për përjashtim në lidhje me projektin e një interkonjeksi që kalon nga Greqia, dhe Shqipëria për të vijuar në Itali (në vijim gazsjellësi TAP) dhe si të tillë për efekt të përjashtimit është e nevojshme përfshirja edhe e autoriteteve rregullatore (në vijim autoritetet) për Greqinë, Enti Rregullator i Energjisë (në vijim RAE) dhe për Italinë, Autoriteti për Energjinë Gazin dhe Sistemet Ujore (në vijim AEEGSI);

- Neni 36, paragrafi 6, i direktivës 73/09 parashikon që autoriteti rregullator, para se të lejojë një përjashtim, duhet të miratojë rregulla dhe mekanizma:

i) Për alokimin e kapacitetit, të cilat kërkojnë që të ftohen të gjithë përdoruesit e mundshëm të infrastrukturës për të shprehur interesin e tyre për përdorimin e kapacitetit përpara se të jetë kryer alokimi i këtij kapaciteti në infrastrukturën e re, përfshirë edhe për vetëpërdorim (këtu e në vazhdim: testimi i tregut).

ii) Për menaxhimin e kapaciteteve, të cilat përfshijnë të drejtën e zotëruesit për të shitur kapacitetet e papërdorura në tregun dytësor dhe detyrimin për të ofruar kapacitetin e papërdorur në treg në rast të “kufizimit kontraktual”;

- Dispozita e mësipërme, gjithashtu, kërkon që në vlerësimin e kritereve për dhënie përjashtimit të kërkuar, autoritetet rregullatore duhet të marrin parasysh rezultatet e procedurës së alokimit të kapaciteteve;

- Në përputhje me dispozitat e sipërpërmendura, është zhvilluar një fazë e parë jodetyruese e testimi të tregut (faza e shprehjes së interesit/*Expression of Interest Phase*), në të cilën të gjithë përdoruesit e mundshëm të gazsjellësit TAP ishin të ftuar për të shprehur interesin e tyre për përdorimin e kapacitetit të kësaj infrastrukture, si në lidhje

me kapacitetin e ofruar nga TAP, ashtu edhe me propozimet për lloje të ndryshme të produkteve të ofruara.

- Në përfundim të fazës së parë të testimi të tregut (faza e shprehjes së interesit/*Expression of Interest Phase*), pasi ERE i cilësoi të plotësuar kushtet e nenit 36 pika 6 të direktivës 73/09, me vendimin nr. 64, datë 13.6.2013 të Opinionit të Përbashkët Përfundimtar/*Final Joint Opinion*, ka shprehur mendim pozitiv për çështjen e vendimit formal për përjashtimin në favor të kompanisë TAP AG;

- I sipërcituari Opinioni i Përbashkët Përfundimtar/*Final Joint Opinion* parashikon edhe një fazë të dytë të testimi të tregut, në të cilin pjesëmarrësit e fazës së parë janë të ftuar të dorëzojnë kërkesat për rezervimin e kapacitetit të tubacionit (TAP “*Booking Phase*”);

- Në zbatim të ekzekutimit të fazës së parë të rezervimit/*First Booking Phase*, të planifikuar për 17 mars 2014, ERE ka përgatitur së bashku me RAE dhe AEEGSI “Udhëzuesin për menaxhimin dhe alokimin e kapaciteteve të projektit Trans Adriatic Pipeline (TAP) në përputhje me paragrafin 6 të nenit 36 të direktivës 2009/73/EC-faza e dytë: ftesa për palët e interesuara të dorëzojnë kërkesa rezervimi detyruese për produktet e kapacitetit/*Guidelines for management and allocation of capacity of the Trans Adriatic Pipeline (TAP) project according to paragraph 6 of Article 36 of the Directive 2009/73/EC –Phase II: invitation to interested Parties to submit binding booking request for capacity products*” (këtu e në vazhdim: *the Guidelines*), të miratuar në vendimin nr. 16, datë 13.3.2014, që nga ana e tij ka për qëllim të përcaktojë parimet e përgjithshme të cilave TAP AG duhet t'i përmbahet për hartimin e procedurës për pjesëmarrje në fazën e rezervimit/*Booking Phase* dhe për menaxhimin dhe alokimin e kapaciteteve të gazsjellësit që janë disponibël;

- Në lidhje me pikën e mësipërme, ky udhëzues parashikon, në veçanti, që TAP AG të hartojë rregullat e sipërpërmendura të procedurës në njoftimin për fazën e rezervimit/*Booking Phase Notice*, e cila do t'i nënshtrohet aprovimit të përbashkët të rregullatorëve.

- Rregullat e sipërpërmendura të procedurës kanë qenë objekt i një bashkëpunimi të frytshëm midis TAP AG dhe autoriteteve rregullatore të Shqipërisë, Greqisë dhe Italisë me qëllim hartimin e tyre në përputhje me udhëzuesin e hartuar nga këto autoritete.

- Së fundmi, në datën 12 mars 2014, shoqëria TAP AG i ka paraqitur një propozim të “Njoftimit për fazën e rezervimit/*Booking Phase Notice*”, ERE-s, si edhe autoriteteve RAE dhe AEEGSI, në mënyrë që të marrë miratimin e tyre.

Duke marrë parasysh që:

- “Njoftimi për fazën e rezervimit/*Booking Phase Notice*” është në përputhje me udhëzuesin/*Guidelines*, të miratuar me vendimin nr. 16, datë 13.3.2014.

- I njëjti opinion ndahet edhe nga RAE dhe AEEGSI.



- Është e nevojshme të miratohet skema e propozuar nga "Njoftimi për fazën e prenotimit/Booking Phase Notice", bashkëngjitur me këtë dispozitë, në mënyrë që të vijojë ekzekutimi i fazës së parë të rezervimit/First Booking Phase.

**VENDOSI:**

1. Të miratojë "Njoftimin e fazës së rezervimit/Booking Phase Notice" të propozuar nga TAP AG në datën 12.3.2014, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Njoftimin e autoriteteve rregullatore të energjisë të Italisë (AEEGSI) dhe Greqisë (RAE) dhe TAP AG, për marrjen e këtij vendimi.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI  
Petrit Ahmeti**

**VENDIM**

**Nr. 18, datë 21.3.2014**

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR  
LICENCIMIN E SHOQËRISË "ENREL HYDRO"  
SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË  
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-et  
"ZEREC 1" DHE "ZEREC 2"**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, germa "a", nenit 9 dhe nenit 13, pika 1, germa "a", të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa "a" dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3 të rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, nenit 18, pika 1, germa "a", të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 21.3.2014, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "EnRel Hydro" sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe të Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "EnRel Hydro" sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar pjesërisht: janë plotësuar gjerat "a", "b", "c", "d", "f" dhe "g", është pa

plotësuar germa "e" (struktura e ndërtimit dhe funksionimit administrativ të shoqërisë).

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar pjesërisht: janë plotësuar gjerat "a", "b" dhe "d", është pa plotësuar germa "c" (dokumente që vërtetojnë aftësinë dhe/ose mbështetjen financiare të aplikuesit).

- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4) është plotësuar pjesërisht: janë plotësuar pikat: 4.1.1, 4.1.2, 4.1.4, 4.1.5, është pa plotësuar pika 4.1.3 (dokumentacioni teknik dhe grafik).

Mungesa e dokumentacionit që ka të bëjë me pikat e sipërcituara, do t'i kërkohej subjektit të depozitohet në ERE brenda afateve të përcaktuara në rregulloren "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave".

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

**VENDOSI:**

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të "EnRel Hydro" sh.p.k., për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et "Zerec 1" dhe "Zerec 2".

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI  
Petrit Ahmeti**

**VENDIM**

**Nr. 19, datë 21.3.2014**

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR  
LICENCIMIN E SHOQËRISË "ENREL HYDRO"  
SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË  
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2 germa "a"; 9 dhe 13, pika 1, germa "d", të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa "g"; 8 dhe 10, pika 3 të rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, nenit 18, pika 1, germa "a", të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 21.3.2014, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "EnRel Hydro" sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë

Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “EnRel Hydro” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar pjesërisht: janë plotësuar germa “a”, “b”, “c”, “d”, dhe është pa plotësuar germa “e” (struktura e ndërtimit dhe funksionimit administrativ të shoqërisë).

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4/10) është plotësuar pjesërisht: janë pa plotësuar germa “a” dhe “b” (sasia e energjisë elektrike e parashikuar për t’u tregtuar, kapitali financiar i parashikuar për ushtrimin e aktivitetit).

Mungesa e dokumentacionit që ka të bëjë me pikat e sipërcituara, do t’i kërkohej subjektit të depozitohet në ERE brenda afateve të përcaktuara në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë dhe të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

#### VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “EnRel Hydro” sh.p.k., për licencim në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
Petrit Ahmeti

#### VENDIM Nr. 20, datë 21.3.2014

#### PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “MTC ENERGY” SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “RADOVË”

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, germa “a”, nenit 9 dhe nenit 13, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “a”, dhe neneve 13 dhe 14 pika 1 të rregullores “Për procedurat e licencimit,

modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 21.3.2014, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “MTC Energy” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “MTC Energy” sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

#### VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “MTC Energy” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Radovë” me fuqi 2,5 Mw.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
Petrit Ahmeti

#### VENDIM Nr. 21, datë 21.3.2014

#### PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “MTC ENERGY” SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 8, pika 2 germa “a”; 9 dhe 13, pika 1, germa “d”, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “g”; 5 pika 2; 13 dhe 14 pika 1 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i

Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 21.3.2014, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “MTC Energy” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “MTC Energy” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.10 germat “a”, “b” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

#### VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “MTC Energy” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 30-vjeçar.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
Petrit Ahmeti

#### VENDIM Nr. 22, datë 21.3.2014

#### PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT PRODHUES TË SHOQËRISË “MTC ENERGY” SHPK NGA HEC “RADOVË”

Në mbështetje të neneve 8, pika 2, germa “ll”, 9 dhe 39 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 3, pika 1, germa “f”, të ligjit nr. 138/2013, datë 2.2.2013 “Për burimet e energjisë së rinovueshme”, të nenit 9, pikat 1 dhe 2, germa “a”, të “Rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme”, të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 9, datë 21.2.2007, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 21.3.2014, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “MTC

Energy” sh.p.k. për kualifikimin e impiantit prodhues për HEC “Radovë”, si burim i rinovueshëm energjie, konstatoi se:

Aplikimi i paraqitur nga shoqëria “MTC Energy” sh.p.k., është konform “Rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme”, si më poshtë:

- Neni 7, pika 1, germat “a”, “b”, “c”, “d”

Përshkrimi i përgjithshëm i centralit.

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

- Neni 7, pika 2, germat “a”, “b”, “c”, “d”

Dokumentacioni vijues grafik, korografia, planimetria e përgjithshme, skema funksionale etj.

Ky dokumentacion është paraqitur në mënyrë korrekte.

- Neni 7, pika 3, germat “a”, “b”, “c”

Përshkrimi i centralit...

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

#### VENDOSI:

1. Të kualifikojë impiantin prodhues të shoqërisë “MTC Energy” sh.p.k. nga HEC “Radovë”, si burim i rinovueshëm energjie.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
Petrit Ahmeti

#### VENDIM Nr. 23, datë 21.3.2014

#### PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENCIMIT TË SHOQËRISË “DANSKE COMMODITIES ALBANIA” SHPK NË AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TË KUALIFIKUAR TË ENERJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 3, pika 31; 8, pika 2, germa “a”; 9 dhe nenit 45, pika “4”, dhe 48, pika 2, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, të neneve 4, pika 1, germa “f”; 5, pika 1, germa “f”; 8, 10, pika 1 dhe 3, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, nenit 18, pika 1, germa “a”, të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 21.3.2014, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria

“Danske Commodities Albania” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Danske Commodities Albania” sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikura nga ERE në “Rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar tërësisht.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar tërësisht.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar tërësisht.

- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.9 germa “a”, “b”, “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

#### VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për licencë të shoqërisë “Danske Commodities Albania” sh.p.k., në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
Petrit Ahmeti

#### VENDIM

Nr. 24, datë 21.3.2014

### **MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “CEZ TRADE ALBANIA” SHPK PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR HEQJEN E LICENCAVE: NR. 91 SERIA TE10P DHE NR. 92 SERIA FP10K, DHËNË ME VENDIMET NR. 1 DHE NR. 2 DATË 20.1.2010 TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S PËR AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERJISË ELEKTRIKE DHE TË FURNIZUESIT TË KUALIFIKUAR TË ENERJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2 germa “a”; 9; 18, pika 1 germa “e”, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 34 dhe 35 të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil në Republikën e Shqipërisë” dhe në zbatim të nenit 5 të rregullores “Për procedurat e heqjes së licencës”, Bordi i

Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 21.3.2014, pasi u njoh me relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike të ERE-s, lidhur me heqjen e licencës shoqërisë “CEZ Trade Albania” sh.p.k.,

konstatoi se:

- Shoqëria “CEZ Trade Albania” sh.p.k., me vendimin nr. 1, datë 20.1.2010 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, është pajisur me licencën nr. 91, seria TE10P, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike të vlefshme për një afat 5-vjeçar.

- Shoqëria “CEZ Trade Albania” sh.p.k., me vendimin nr. 2 datë 20.1.2010 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, është pajisur me licencën nr. 92, seria FP10K, për aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike, të vlefshme për një afat 5-vjeçar.

- ERE, me vendimin nr. 13, datë 3.3.2014, miratoi kërkesën e OST sh.a. për zgjidhjen e “Marrëveshjes për pjesëmarrjen në treg”, të lidhur ndërmjet “CEZ Trade Albania” sh.p.k. në cilësinë e tregtuesit të energjisë elektrike dhe OST sh.a. –OT dhe kërkesën e OST sh.a. zgjidhjen e “Marrëveshjes për pjesëmarrjen në treg”, të lidhur ndërmjet “CEZ Trade Albania” sh.p.k. në cilësinë e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike dhe OST sh.a.–OT.

- “CEZ Trade Albania” sh.p.k., me shkresën nr. 12/26 Prot., datë 26.12.2013 (depozituar në OST) njofton se kjo shoqëri i është nënshtruar procesit të likuidimit.

- Shoqëria “CEZ Trade Albania” sh.p.k., me shkresën nr. 1058 Prot., datë 27.12.2013, ka kërkuar nga ERE fillimin e procedurave për heqjen e licencave të sipërcituara duke qenë se është shoqëri në likuidim dhe dëshiron të dalë nga tregu i energjisë elektrike me vullnetin e saj.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

#### VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “CEZ Trade Albania” sh.p.k., për heqjen e licencës me nr. 91 seria TE10P, miratuar me vendimin nr. 1, datë 20.1.2010 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, të vlefshme për një afat 5-vjeçar.

2. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “CEZ Trade Albania” sh.p.k., për heqjen e licencës me nr. 92 seria FP10K, miratuar me vendimin nr. 2, datë 20.1.2010 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, për aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike, të vlefshme për një afat 5-vjeçar.

3. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë shoqërinë “CEZ Trade Albania” sh.p.k., për vendimmarrjen e ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
Petrit Ahmeti

**VENDIM**  
**Nr. 25, datë 21.3.2014**

**MBI KËRKESËN PËR FILLIMIN E NJË  
PROCEDURE HETIMORE ADMINISTRATIVE  
PËR SHPALLJEN ABSOLUTISHT TË  
PAVLEFSHME TË VENDIMEVE NR. 69 DHE 70,  
DATË 12.12.2007 TË BORDIT TË  
KOMISIONERËVE TË ERE-S QË KANË  
TRANSFERUAR LICENCAT NGA SHOQËRITË  
KONCESIONARE “ESSEGEI SHQIPËRI  
SMOKTHINA” SHPK DHE “HYDROELECTRIC  
COMPANY OF ALBANIA” SHPK TË  
SHOQËRITË “ALBANIAN GREEN ENERGY”  
DHE “BALKAN GREEN ENERGY”**

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 36, paragrafi i dytë i Kodit të Procedurës Civile; neneve 15 dhe 18, germa “b”, të ligjit nr. 8485 datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurës Administrative në Republikën e Shqipërisë”, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 21.3.2014, pasi u njoh me relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike të ERE-s, lidhur me kërkesën e z. Grigor Zoraci në cilësinë e personit të interesuar dhe ortakut të shoqërive koncesionare “Essegei Shqipëri Smokthina” sh.p.k. dhe “Hydroelectric Company of Albania” sh.p.k., për fillimin e një procedure hetimore administrative për shpalljen absolutisht të pavlefshme të vendimeve nr. 69 dhe 70, datë 12.12.2007 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, konstatoi se:

- Me vendim të Bordit Komisionerëve të ERE-s nr. 2, datë 3.4.2002, është licencuar shoqëria koncesionare “Essegei-Shqipëri” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike.

- Me vendim nr. 2, datë 27.1.2003 të ERE-s i hiqet licenca shoqërisë “Essegei-Shqipëri” sh.p.k., për mosplotësim të kushteve të licencës dhe paaftësi menaxhuese dhe është caktuar si administrator, për të marrë përsipër shfrytëzimin e pajisjeve në licencë shoqëria “Essegei-Shqipëri Smokthina” sh.p.k., e cila do të plotësojë të gjitha detyrimet e përcaktuara në licencë.

- Me vendimin nr. 15, datë 27.8.2003, është licencuar nga ERE “Essegei Shqipëri Smokthina” sh.p.k., për prodhimin e energjisë elektrike, licencë nr. 05, seria PO3K.

- Me vendimin nr. 20, datë 19.12.2003, Bordi i Komisionerëve të ERE-s ka vendosur dhënien e licencës shoqërisë “Hydroelectric-Company d’Albania” sh.p.k. me cilësinë e shoqërisë koncesionare për shfrytëzimin e centraleve të dhëna me koncesion (licenca me nr. 13, seri PV03K).

- Me vendimin nr. 69, datë 12.12.2007 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, ka vendosur që licenca nr. 13, seria PVO3K, datë 19.12.2003 e shoqërisë “H.C.A”

sh.p.k., t’i transferohet shoqërisë “Balkan Green Energy”, sh.p.k. Kjo shoqëri mban të gjitha të drejtat dhe detyrimet e parashikuara në licencën e prodhimit të energjisë elektrike nr. 13 seria PVO3K, dhënë me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 20, datë 19.12.2003.

- Me vendimin nr. 70, datë 12.12.2007 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s është vendosur që licenca nr. 05, seria PO3K, datë 27.8.2003, e shoqërisë “Essegei Shqipëri Smokthina” sh.p.k. t’i transferohet shoqërisë “Albanian Green Energy” sh.p.k. Kjo shoqëri mban të gjitha të drejtat dhe detyrimet e parashikuara në licencën e prodhimit të energjisë elektrike nr. 05, seria PO3K, dhënë me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 15, datë 27.8.2003.

- Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në bazë të vërtetimit datë 9.9.2013 të lëshuar nga kjo gjykatë është regjistruar çështja civile me nr. 171 Akti, datë 4.6.2009 depozitimi, dhe datë regjistrimi 5.6.2009 me palë paditëse Grigor Zoraci; të paditur: Giorando Gorini, Aldo Francescheti, shoqëria “Essegei” s.p.a., shoqëria “Albanian Green Energy” sh.p.k., shoqëria “Balkan Green Energy” sh.p.k., Ministria e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës dhe Enti Rregullator i Energjisë.

- Kjo çështje vazhdon të jetë objekt konflikti gjyqësor ndër vite deri më sot, ku një nga palët ndërgjyqëse është edhe ERE dhe për rrjedhojë, kjo e fundit do të qëndrojë palë deri në zbardhjen nga drejtësia të kësaj çështje me vendim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

**VENDOSI:**

1. Shpalljen e moskompetencës së ERE-s për shqyrtimin e kësaj çështjeje.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit Ahmeti**

**VENDIM**  
**Nr. 26, datë 21.3.2014**

**MBI KËRKESËN E NJË PREJ AKSIONARËVE  
TË SHOQËRISË “PROJEKSION ENERGJI” SHA  
PËR HEQJEN E LICENCËS DHE ZGJIDHJEN E  
MOSMARRËVESHJES MIDIS PALËVE**

Në mbështetje të neneve 8, germa “d” dhe 9, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe nenit 36 paragrafi i dytë i Kodit të Procedurës Civile dhe nenin 18 germa “b” i Kodit të Procedurave Administrative, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 21.3.2014, pasi u njoh me relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike të ERE-s, lidhur me kërkesën e një prej

aksionarëve të shoqërisë “Projeksion Energji” sh.a., për heqjen e licencës nr. 40, seria PV06P, për aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Çarshovë”, “Treska 1” dhe “Rehovë”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Projeksion Energji” sh.a., me vendimin nr. 76, datë 7.11.2006 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, është pajisur me licencën e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentralet “Çarshovë”, “Treska 1” dhe “Rehovë”.

- Bordi i Komisionerëve të ERE-s, me vendimin nr. 47, datë 18.4.2008, ka miratuar kërkesën e shoqërisë “Projeksion Energji” sh.a., për ndryshimin e licencës nr. 40, seria PV06P, për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet “Çarshovë”, “Treska 1” dhe “Rehovë”.

- Aktualisht shoqëria është pa status ligjor nga pamundësia numerike e aksionarëve për të marrë vendim. HEC “Çarshovë” ka kaluar në pronësi të trashëgimtarëve, të ish-pronarëve që e kanë privatizuar. HEC-et “Rehovë” dhe “Treska-1”, siç del dhe nga monitorimi i bërë nga grupi i ERE-s dhe nga akuzat e ndërsjella të aksionarëve janë të dëmtuar nga vetë poseduesit, marrëdhëniet e shoqërisë me institucionet që operojnë janë të provokuara nga akuzat e aksionarëve, dhe marrëdhëniet konfliktuale ndërmjet tyre e kanë çuar shoqërinë për prishje në gjykatë.

- Bazuar në ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, shoqëria “Projeksion Energji” sh.a. nga të dhënat e ekstrakteve të QKR-së rezultojnë e prishur dhe çregjistrimi i saj do të bëhet në bazë të nenit 48-51 me vendim gjyqësor të paankimueshëm për ndarjen e kapitalit (me vërtetimin datë 18.2.2013 të lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, prishja e kësaj shoqërie është objekt gjykimi).

- Kërkesa për heqje licence vjen nga njëri nga aksionarët e shoqërisë dhe jo nga forumet drejtuese të shoqërisë “Projeksion Energji” sh.a.

- Çështjet ku bazohet kërkesa për heqje licence janë objekt konflikti gjyqësor ndërmjet aksionarëve të shoqërisë “Projeksion Energji” sh.a., siç dëshmohet me vërtetimin e datës 18.2.2013 të lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Dhoma Civile, rezultojnë se pranë kësaj Gjykate është regjistruar çështja civile me nr. 624 Akti, datë depozitimi 8.3.2012 dhe datë regjistrimi 12.3.2012. Palët ndërgjyqëse në këtë proces rezultojnë të jenë: paditës z. Sokol Riska, i paditur z. Anastas Riska dhe palë e tretë QKR-ja. Objekti i gjykimit është: Prishja e shoqërisë “Projeksion Energji” sh.a., ndarje e aseteve në përpjesëtim me zotërimin e aksioneve të secili. Vlen të theksohet fakti se kjo çështje është ende në gjykim.

- Në bazë të nenit 8, pika 2, germa “d” të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, ERE ka kompetencë vetëm të zgjidhë mosmarrëveshjet midis të licencuarve. Çdo mosmarrëveshje e lindur midis aksionarëve të shoqërive të licencuara duhet të zgjidhet në gjykatë. Po ashtu Kodi i

Procedurës Civile, në nenin 36 paragrafi i dytë shprehet qartë se: “Asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga gjykata. Dhe Kodi i Procedurës Administrative në nenin 18, germa “b”, përcakton se: “Në mënyrë që të mbrohen të drejtat kushtetuese dhe ligjore të personave privatë, veprimtaria administrative i nënshtrohet: kontrollit nga gjykatat në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Mosfillimin e procedurave për heqjen e licencës së shoqërisë “Projeksion Energji” sh.a.

2. Shpalljen e moskompetencës së ERE-s për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve midis aksionarëve të “Projeksion Energji” sh.a.

3. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 27, datë 31.3.2014

**PËR MIRATIMIN E KONTRATËS TIP MBI  
VERIFIKIMIN E MATËSVE KUR FUTEN PËR  
HERË TË PARË NË TREG DHE/OSE KUR  
VENDOSEN PËR HERË TË PARË NË  
PËRDORIM; INSPEKTIMIN PERIODIK PËR  
VERIFIKIMIN E SAKTËSISË SË MATËSVE DHE  
TË SISTEMIT TË MATJES SË ENERGJISË  
ELEKTRIKE, KOLAUDIMIN DHE VULOSJEN, SI  
DHE TË MIRËMBAJTJES SË TYRE**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 51, pika 9, të ligjit nr. 9072 datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 25 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 31.3.2014, pasi shqyrtoi draftin e kontratës tip mbi verifikimin e matësve kur futen për herë të parë në treg dhe/ose kur vendosen për herë të parë në përdorim; inspektimin periodik për verifikimin e saktësisë së matësve dhe të sistemit të matjes së energjisë elektrike, kolaudimin dhe vulosjen, si dhe të mirëmbajtjes së tyre,

VENDOSI:

1. Të miratojë kontratën tip mbi verifikimin e matësve kur futen për herë të parë në treg dhe/ose kur vendosen për herë të parë në përdorim; inspektimin periodik për

verifikimin e saktësisë së matësve dhe të sistemit të matjes së energjisë elektrike, kolaudimin dhe vulosjen, si dhe të mirëmbajtjes së tyre (bashkëlidhur këtij vendimi).

2. Të shfuqizojë kontratën tip për shërbimin e kontrollit fillestar dhe periodik të matësve të energjisë elektrike, miratuar me vendimin nr. 62, datë 22.7.2011 “Për miratimin e kontratës tip për shërbimin e verifikimit dhe kontrollit fillestar dhe periodik të matësve të energjisë elektrike”.

3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë subjektet e interesuara për vendimmarrjen e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit Ahmeti**

**VENDIM**  
**Nr. 28, datë 31.3.2014**

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENCIMIT TË SHOQËRISË “POWER WIND ENERGY” SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, germa “a”, neneve 9 dhe 13, pikat 1, germa “d”, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “g”, nenit 8; nenit 10, pikat 1 dhe 3 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, dhe nenit 18, pika 1, germa “a”, të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 31.3.2014, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “Power Wind Energy” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Power Wind Energy” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik (nenin 9, pika 4.10, germa “b”) është paraqitur në mënyrë jo korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

**VENDOSI:**

1. Fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për licencë të shoqërisë “Power Wind Energy” sh.p.k., për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit Ahmeti**

**VENDIM**  
**Nr. 29, datë 31.3.2014**

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “AYEN ENERGY TRADING” SHA NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, germa “a”, neneve 9 dhe 13, pikat 1, germa “d”, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si dhe në zbatim të nenit 4 pika 1 germa “g”; nenit 5, germa “g”; nenit 12; nenit 13, si dhe nenit 14, pika 1, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 31.3.2014, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “Ayen Energy Trading” sh.a., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Ayen Energy Trading” sh.a. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik (nenin 9, pika 4.10) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

**VENDOSI:**

1. Të licencojë shoqërinë “Ayen Energy Trading” sh.a. në aktivitetin e tregimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit Ahmeti**

**VENDIM**

**Nr. 30, datë 31.3.2014**

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “AYEN ELEKTRIK TRADING” SHA NË AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TË KUALIFIKUAR TË ENERJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 3, pika 31, nenit 8, pika 2, germa “a”; nenit 9 dhe nenit 45, pika “4”; nenit 48, pika 2, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, në zbatim të nenit 4, pika 1, germa “f”; nenit 5, pika 1, germa “f”; nenit 12; nenit 13; nenit 14 pika 1, germa “f” të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 31.3.2014, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Ayen Elektrik Trading” sh.a., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Ayen Elektrik Trading” sh.a., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.9 germa “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

**VENDOSI:**

1. Të licencojë shoqërinë “Ayen Elektrik Trading” sh.a. në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike, me një afat 5-vjeçar.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit Ahmeti**

**VENDIM**

**Nr. 31, datë 31.3.2014**

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENCIMIT TË SHOQËRISË “GURSHPATE ENERGY” SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERJISË ELEKTRIKE NGA HEC “GURSHPATE 1” DHE HEC “GURSHPATE 2”**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2 germa “a”, të neneve 9 dhe 13, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “a”, nenit 8, nenit 9; nenit 10, pika 1 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, dhe nenit 18, pika 1, germa “a”, të “Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 31.3.2014, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “Gurshpate Energy” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Gurshpate Energy” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar pjesërisht.



- Dokumentacioni teknik (nenin 9, pika 4.1.1) është paraqitur dhe plotësuar pjesërisht.

- Të dhëna teknike për bllokun e transformimit dhe lidhjen me sistemin (neni 9, pika 4.1.2) është paraqitur dhe plotësuar pjesërisht.

- Dokumentacioni teknik dhe grafik (neni 9, pika 4.1.3) është paraqitur dhe plotësuar pjesërisht.

- Dokumentacioni tekniko-ekonomik (neni 9, pika 4.1.4) është paraqitur dhe plotësuar pjesërisht.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

#### VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit për licencë të shoqërisë “Gurshpate Energy” sh.p.k., për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Gurshpate 1” dhe “Gurshpate 2”.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit Ahmeti**

#### **VENDIM**

*(i shkurtuar)*

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 2502, datë 21.2.2014, vendosi shpalljen të zhdukur që nga data 22.8.1977 të shtetasit Muhamed Demaj, i biri i Ramazanit dhe i Hajrijes, i datëlindjes 16.12.1950, Tiranë, si dhe caktimin në cilësinë e kujdestares për administrimin e pasurisë së tij, motrën e tij, shtetasen Mevlude Demaj.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare me çmimin 16 000 lekë ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare me çmimin 14 000 lekë (ky çmim nuk përfshin shpërndarjen në adresë)

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2014

Çmimi 44 lekë

Adresa: bulevardi "Gjergj Fishta", pas ish-ekspozitës "Shqipëria Sot",  
Tel: 04 24 27 005, 04 24 27 006